

# AKADEMIA EVROPIANE PËR ENERGJINË E QYTETARËVE

UDHËZUES PËR PRAKTIKAT MË TË  
MIRA NË EVROPËN JUGLINDORE

Nisma frymëzuese mbi komunitetet e energjisë



# AKADEMIA EVROPIANE PËR ENERGJINË E QYTETARËVE

UDHËZUES PËR PRAKTIKAT MË TË  
MIRA NË EVROPËN JUGLINDORE

Nisma frymëzuese mbi komunitetet e energjisë



**Autor:** Dr. Antonia Proka (REScoop.eu). **Kontribues:** MSc Chris Vretos (Electra Energy), MSc Dimitris Kitsikopoulos (Electra Energy), MSc Valbona Mazreku (Mileukontakt Albania).

Ky botim u përgatit në kuadër të Projektit EUCENA. Projekti është pjesë e Nismës Evropiane për Klimën (EUKI) së Ministrisë Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik (BMWK). Opinionet e paraqitura në këtë studim janë përgjegjësi vetëm e autores/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik (BMWK).

REScoop.eu


WWW.REScoop.eu

REScoop.eu është federata evropiane e kooperativave qytetare të energjisë. Ne jemi një rrjet në rritje i 1.900 kooperativave që veprojnë në Evropë dhe së bashku përfaqësojnë mbi 1.25 milion qytetarë.



WWW.CITIZENERGY.ACADEMY

Supported by:





# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b>	<b>4</b>
<b>2. QEVERISJA E KOMUNITETEVE PËR ENERGINË</b>	<b>7</b>
<b>3. ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESIT</b>	<b>12</b>
<b>4. AVOKIMI PËR POLITIKAT</b>	<b>20</b>
<b>5. PARTNERITETET &amp; RRJETET</b>	<b>26</b>
<b>6. FINANCIMI</b>	<b>34</b>
6.1 Mbledhja e fondeve në internet	34
6.2 Vetë-financimi & huatë bankare	41
<b>7. VEPRIMTARITË</b>	<b>43</b>
7.1 Prodhimi: Energjia diellore	43
7.2 Prodhimi: Biomasa	47
7.3 Eficenca e energjisë	49
7.4 Konsulenca & Shërbimet këshillimore për nismat e komuniteteve të reja	55
7.5 Furnizimi me energji	57
<b>8. ENERJIA KOMUNITARE PËR ... TEJKALIMIN E "BALLKANIZIMIT"</b>	<b>60</b>



© REScoop.eu

## 1

## HYRJE

Ky udhëzues është shkruar në kohën e asaj që shpesh quhet “kriza globale e energjisë”. Çmimet e energjisë janë rritur në qiell dhe mundësia për furnizim të mjaftueshëm me gaz “natyror”, apo më mirë me gaz fosilesh për të përmbushur nevojat e shoqërive tona të varura prej tij bëhet përherë e më e paqartë. Kjo krizë energjetike, e kombinuar me atë klimatike, i lë miliona njerëz në mbarë botën pa mundësi për një burim të sigurt, të pastër dhe të qëndrueshëm të energjisë.

Për këto kriza të ndërthurura dhe të ndërlidhura ka zgjidhje, por duhet vepruar tani. Në këtë udhëzues, përfshihen shembuj të nismave frymëzuese të komuniteteve për energjinë ku njerëzit ndërmarrin veprime për të përmirësuar kushtet e tyre dhe mirëqenien e komuniteteve ku bëjnë pjesë.

Komunitetet energjetike punojnë për krijimin e një sistemi energjetik të decentralizuar, të rinovueshëm, të pastër dhe efikas, i cili ka në qendër qytetarët. Vetëkuptohet që këto komunitete mund të kontribuojnë në heqjen graduale të lëndëve fosile, duke forcuar në të njëjtën kohë rezistencën ndaj rritjes së çmimeve të energjisë dhe importit të saj, përmes gjenerimit të energjisë të rinovueshme dhe kursimit të saj, të gjitha në funksion të zhvillimit ekonomik lokal.

Qëllimi i këtij botimi është të ilustrojë praktikat e mira të komuniteteve energjetike në rajon, të frymëzojë më shumë qytetarë që të fillojnë punën për krijimin e komuniteteve të tyre energjetike, duke ecur në hapat e nismave të mëparshme dhe duke kërkuar ndihmën e komuniteteve që janë në pararojë.

## ÇFARË JANË KOMUNITETET ENERGETIKE?

Termi “Komunitetet Energjetike” u referohet njerëzve në një komunitet, të cilët bëhen bashkë për trajtimin e çështjes së energjisë. Energjia e komunitetit është një koncept i gjerë, i cili mund t’u referohet fushatave për eficiencën e energjisë, investimeve kolektive në panele diellore apo turbina me erë, por edhe pronësisë së përbashkët mbi një kompani furnizimi me energji, apo edhe një rrjeti shpërndarjeje. Komunitetet energjetike bashkojnë njerëzit për ndërmarrjen e veprimeve klimatike demokratike duke rritur kuptimin për energjinë dhe duke e gjeneruar, zotëruar, përdorur, ndarë dhe kursyer atë së bashku.

Në varësi të aktivitetit, komunitetet energjetike mund të marrin forma të ndryshme. Këto forma përfshijnë (por nuk kufizohen në) kooperativat, partneritetet, fondacionet, organizatat jofitimprurëse, trustet dhe shoqatat.

Që nga viti 2019, nga Bashkimi Evropian janë njohur si të ligjshme dy lloje të komuniteteve energjetike duke sinjalizuar, kështu, një zhvendosje të fortë në rolin e qytetarëve nga konsumatorë pasivë në pjesëmarrës aktivë në tranzicionin e energjisë. Përkufizimet e “komuniteteve të energjisë së rinovueshme” në [Direktivën e Energjisë së Rinovueshme](#), të rishikuar, dhe “komuniteteve qytetare të energjisë” në [Direktivën e Tregut të Brendshëm të Energjisë Elektrike](#) ofrojnë një kuadër ligjor mbështetës për pronësinë e energjisë në komunitet. Ato përcaktojnë një sërë kriteresh që duhet të plotësohen në mënyrë që një kolektiv të konsiderohet si komunitet energjetik, ku përfshihet pronësia, parimet e qeverisjes dhe qëllimi jo-komercial i këtyre nismave.



Në Paketën e Energjisë së Pastër ka dy përcaktime të ndryshme ligjore të projekteve të energjisë komunitare. Së pari, Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme, ose KER, të cilat përcaktohen në Direktivën për burimet e rinovueshme dhe së dyti Komunitetet e Energjisë Qytetare, ose KEQ, që përcaktohen në Direktivën e Tregut të Brendshëm të Energjisë. Këto përkufizime janë shumë të ngjashme, ekzistenca e përkufizimeve lidhet me faktin se dy departamente të ndryshme punonin për një legjislacion të ngjashëm në të njëjtën kohë. Të dy këto përkufizime kanë gjërat më të rëndësishme të përbashkëta, të dyja kërkojnë që komunitetet energjetike të kenë një mision që lidhet me vlerat ekonomike mjedisore, sociale ose lokale dhe jo me fitimin. Të dyja kërkojnë që kontrolli mbi projektin të jetë në duart e "personave realë" si qytetarët, kooperativat apo autoritetet lokale. Ka disa dallime në anëtarësimin që lejohet dhe teorikisht vetëm KER-et kërkohej të jenë thjesht për energjinë e rinovueshme. Gjëja kryesore është të mos lejoni që përkufizime të ndryshme t'ju ngatërrojnë ose shpërqendrojnë: të dyja janë përkufizime të dobishme ligjore që njohin vlerën e përfshirjes së komunitetit në tranzicionin e energjisë.

**Burimi:** *Energjia e Komunitetit: Një udhëzues praktik për rikuperimin e energjisë.*

**Dëshironi të mësoni më shumë? Shiko:**  
*Komunitetet e Energjisë në kuadrin e Paketës së Energjisë së Pastër: Udhëzues për Transpozimin.*



Pavarësisht nga forma ligjore, modeli i biznesit apo teknologjitë e përdorura, komunitetet energjetike ndjekin gjithmonë një qasje kolektive. Një komunitet energjetik është një model organizativ që u mundëson aktorëve lokalë të bashkëpunojnë dhe të ndërmarrin veprime për të zbatuar projekte për energji të qëndrueshme në komunitetet e tyre. Këto sipërmarrje zotërohen dhe kontrollohen nga anëtarët e komunitetit.

Në thelbin e vet, komuniteti i energjisë është një koncept organizativ që karakterizohet nga:

- Anëtarësimi i hapur: Hapja dhe garantimi i pjesëmarrjes vullnetare së kujt do.
- Kontrolli demokratik i anëtarësisë: Sipërmarrjet kontrollohen në mënyrë efektive nga anëtarësia, çka zakonisht kërkon një mekanizëm për qeverisjen demokratike.
- Natyra specifike e anëtarëve: Anëtarët mund të jenë persona fizikë (d.m.th. konsumatorë privatë), bashki dhe/ose ndërmarrje të vogla (dhe shpesh të mesme) (NVM).
- Interesi i komunitetit mbi të gjitha: Qëllimi i tyre kryesor është të ofrojnë përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale për komunitetin, dhe jo aq shumë të sigurojnë fitime financiare.



© grafikplusfoto - stock.adobe.com

## CILAT JANË PËRFITIMET E NISMAVE TË ENERGJISË NË KOMUNITET?

Organizatat komunitare të energjisë janë tashmë në ballë të transformimit të nevojshëm të sistemit energjetik. Ato kanë bërë të mundur që teknologjitë e energjisë së rinovueshme të pranohen gjithnjë e më lehtë, kanë shënuar fillimin e ndryshimit të sjelljes, kanë përsheptuar decentralizimin e sistemit energjetik, kanë reduktuar emetimet e karbonit, si dhe kanë fuqizuar dhe rritur aftësitë e komuniteteve. Energjia komunitare shërben si bazë për krijimin e dakordësisë, besimit dhe pjesëmarrjes aktive të nevojshme për të siguruar një tranzicion të drejtë dhe solid të energjisë. Këto aspekte trajtohen më në hollësi më poshtë.


- Projekt energjetik sipas nevojave të komunitetit**  
 Komunitetet e energjisë promovojnë projekte të energjisë së rinovueshme që janë të përshtatshme dhe që përshtaten më së miri me kushtet e tyre lokale. Ato mobilizojnë kredi private dhe ri-kanalizojnë paratë që aktualisht shkojnë në sistemin e karburanteve fosile. Për më tepër, projektet e energjisë në komunitet mund të ofrojnë fleksibilitet dhe të rrisin besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e të gjithë sistemit.
- Ndryshimi kulturor**  
 Duke vendosur kontrollin demokratik, pjesëmarrjen aktive dhe shpërndarjen e drejtë të kostos/përfitimit në qendër të çdo projekti zhvillimor, komunitetet e energjisë krijojnë një bazë për ndryshimin e rëndësishëm infrastrukturor dhe kulturor që na nevojitet për të pakësuar ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe për të rritur sigurinë tonë energjetike.
- Përfitimet ekonomike lokale**  
 Projektet e energjisë komunitare gjenerojnë 2 deri në 8 herë më shumë të ardhura vendore sesa një projekt i realizuar nga një aktor i jashtëm (siç kanë treguar projektet e energjisë së diellit dhe erës).<sup>1</sup> Ato krijojnë vende pune dhe mund të ndihmojnë në krijimin e tregjeve lokale të energjisë ku konsumatorët mund të blejnë energji me çmim të qëndrueshëm dhe të drejtë. Duke krijuar mundësi ekonomike lokale, ato gjithashtu ndihmojnë në moslargimin e popullsisë nga zonat rurale.

- Varfëria energjetike**  
 Shumë projekte energjetike në pronësi të komunitetit ofrojnë një sasi energjie me kosto të ulët për personat e përfshirë, si dhe shpesh ndërmarrin nisma për të mbështetur njerëzit vulnerabël në komunitetet e tyre, duke ndihmuar kështu në trajtimin e varfërisë energjetike.
- Forcimi i aftësive të komuniteteve**  
 Pjesëmarrja dhe veprimi brenda komuniteteve të energjisë duket se forcon edhe një lloj ndjenje identitare, si dhe kohezionin social, pasi rrit dialogun dhe bashkëpunimin midis dhe brenda komuniteteve. Projektet e drejtuara nga komuniteti për energjinë e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë fuqizojnë qytetarët, pasi përmes përfshirjes në to, qytetarët fitojnë njohuri teknike, aftësi dhe shprehje që i kapërcejnë ato që mundësohen nga një investitor tradicional. Për më tepër, shpesh vërehet një "rrjedhje" e novatorizmit, që do të thotë se qytetarët që punojnë së bashku në një projekt diellor, më vonë mund të bashkëpunojnë edhe për zhvillimin e p.sh. një skemë për përdorimin e përbashkët të makinave elektrike.
- Rritja e ndërgjegjësimit**  
 Dhe, duke qenë se pavarësisht rritjes së efikasitetit të energjisë, kërkesa për energji në nivel global vazhdon të rritet, disa komunitete energjetike e vënë theksin tek sigurimi i energjisë së mjaftueshme. Komunitetet e energjisë rrisin ndërgjegjësimin për kalimin drejt një të ardhmeje ku çdokush në planetin tonë të ketë mundësi të përballojë shërbimet energjetike që i nevojiten, duke respektuar limitet sociale dhe mjedisore. Në përgjithësi, komunitetet e energjisë ofrojnë përfitime të shumta dhe promovojnë një qasje sistematike ndaj një tranzicioni shoqëror të drejtë, objektiv dhe të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore në fushën e energjisë, i cili mund të sigurojë një mënyrë jetese më të shëndetshme dhe të lumtur për të gjithë.

<sup>1</sup> <https://www.rescoop.eu/news-and-events/news/ten-reasons-to-start-or-join-a-community-energy-project>

### BURIME TË TJERA

- Definition, benefits and potential of community energy*
- Community Energy: A practical guide to reclaiming power*
- Mapping the Social Impact of Energy Communities*





# QEVERISJA E KOMUNITETEVE ENERGETIKE

# 2


**Krijimi i një komuniteti energjetik kërkon kohë. Nëse filloni rrugëtimin për konkretizimin e vizionit dhe dëshirës suaj për të sjellë një ndryshim të thellë dhe të qëndrueshëm në komunitetin tuaj dhe në sistemin energjetik, së shpejti do të kuptoni se grupi juaj duhet të jetë i fortë dhe i bashkuar për të vazhduar punën së bashku. Për këtë, ju nevojitet një strukturë e qartë organizative dhe qeverisje e brendshme transparente, pra rregulla për marrjen e vendimeve me ndikim në komunitetin e energjisë. Komunitetet e energjisë janë organizata demokratike dhe autonome.**

Shpesh struktura organizative e një komuniteti energjetik përbëhet nga një grup kryesor njerëzish që kanë përgjegjësi të përbashkëta për projektin në një afat të gjatë kohor. Ky grup mund të ketë 4 - 15 ose më shumë anëtarë. Sa më shumë njerëz të ketë në ekipin kryesor, aq më mirë. Është me rëndësi të gjeni kohë për të kuptuar motivimet e njëri-tjetrit dhe çfarë ju bashkon. Kjo do t'ju ndihmojë të ndani më mirë detyrat dhe përgjegjësitë. Mund të filloni duke ngritur një bord për konceptimin e vizionit, ku së bashku të eksploroni idetë për projektin e ri.

## HAPAT E PARA

Hapi i parë në krijimin e një komuniteti energjetik do të jetë përvijimi më qartë i projektit tuaj duke lënë hapësirën e duhur për përshtatje të mundshme në të ardhmen. Procesi për rrahjen e mendimeve duhet, gjithashtu, të marrë në konsideratë burimet dhe sfidat me të cilat do të përballeni gjatë realizimit të objektivave tuaja. Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë në hartimin e një versioni të parë të projektit:

- Kush jemi ne?
- Çfarë duam të bëjmë së bashku? Cili është projekti ynë?
- Cilat janë objektivat tona të përbashkëta?
- Si do të formohet grupi fillestar i palëve të interesuara?
- Çfarë burimesh kemi brenda grupit (teknike/financiare/sociale/politike)?
- Çfarë na mungon dhe barrierat me të cilat do të përballemi?



Mendoni për këto pyetje si një mënyrë për të filluar hartimin e dokumenteve statutores. Këto përgjigje do të jenë nenet përkatëse lidhur me objektin e organizatës, vlerat e saj, qëllimin e komunitetit të energjisë dhe rezultatin fundor të tij. Ato u referohen neneve themelore për bashkëpunimin në kuadrin e një kooperative: objektivi i organizatës është fusha e veprimtarisë së saj, vlerat lidhen me mënyrën se si komuniteti do t'i realizojë veprimtaritë e tij. Qëllimi është vlera konkrete që organizata do të sjellë për pjesëmarrësit e saj. Rezultati fundor ka të bëjë me vlerën e shtuar të projektit për shoqërinë në përgjithësi. Siç e kuptoni, qëllimi dhe finaliteti (rezultati fundor) i një Komuniteti për Energjinë shpesh mund të shkrihen në një, por është mirë që finaliteti të lidhet me një qëllim më të madh dhe objektivat me vlerën e shtuar konkrete.

**Mësoni më shumë:** <https://www.compile-project.eu/products/coolkit/stakeholder-engagement/>



# KOMUNITETI ENERGJETIK I KARDITËS (ESEK)

GREQI | RURAL | RAJONALE



Komuniteti Energjetik i Karditës (ESEK) u themelua në vitin 2010 si një "kooperativë fitimprurëse energjetike për qytetarët" për të përmbushur vizionin dhe për të shpërblyer përpjekjet e më shumë se 350 anëtarëve. Qëllimi kryesor ishte nxitja e energjisë së rinovueshme në rajon. Në vitin 2019, sipas përcaktimeve të ligjit 4513/2018 dhe me vendim unanim të Asamblesë së Përgjithshme, Kooperativa Energjetike u shndërrua në Komunitet Energjetik.

## Themelimi (viti)

Kooperativa Energjetike 2010 – Komuniteti Energjetik 2019.

## Teknologjitë e energjisë së rinovueshme

Bio-karburet e ngurta (biomasa) / Foto-Voltaikët (qëllimi afatshkurtër i ardhshëm).



## Motivi kryesor (për themelimin)

ESEK operon në Thesali, një zonë me prodhim bujqësor të zhvilluar. Zgjerimi i vazhdueshëm i rrjetit lokal të lëndëve fosile rrezikon të marrë përparësi mbi ngrohjen me bazë energjinë e rinovueshme, siç janë kaldajat me biomasë. Në të njëjtën kohë, rajoni ka një potencial të madh të zinxhirit të furnizimit të biomasës përmes bujqësisë, pylltarisë dhe industrive të përpunimit të drurit që mund të mbështesin pa ndonjë vështirësi kalimin në teknologjitë e bioenergjisë.

Agiophgh, 43100, Greece,  
Thessaly, Karditsa,

info@esek.gr,  
+30 6945179170

[www.esek.gr](http://www.esek.gr)

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Anëtarët: NVM-të: 5,2 %. Bashkitë: 1,5 %. Qytetarë burra: 74,7 %. Qytetare gra: 18,6 %. **Shënim:** Burrat shënojnë shumicën sepse zakonisht janë burrat ata që përfaqësojnë të gjithë familjen.

## Aktorët kryesorë dhe palët e interesuara (përfshirë partneritetet kryesore)

Transportuesit e biomasës, furnizuesit e biomasës (sharrat, kooperativat pyjore, fermerët, bashkitë) furnizuesit e mallrave të konsumit, teknikët (hidraulikë, elektrikistë, inxhinierë) etj.

## Aktivitetet

Aktiviteti kryesor i Komunitetit të Energjisë lidhet me menaxhimin e një impianti të biomasës për prodhimin e biokarbureve të ngurta për të gjeneruar energji për qëllime ngrohjeje (ose ftohjeje). Faza e parë e projektit të investimit ka çuar në krijimin e një Komuniteti Energjetik me një implant solid biokarburesh, i cili mund të krijojë zinxhirin e vlerës për komunitetin lokal. Është krijuar një njësi prodhuese për përpunimin dhe standardizimin e biomasës lokale dhe shndërrimin e saj në një formë komerciale, si është peleti. Lënda e parë për prodhimin e peletit

përbëhet nga mbetjet industriale (sharrat) si copat e tallashit të drurit dhe mbetjet e prerjeve nga kooperativat pyjore si degët, majat dhe trungjet e pemëve. Partneritetet me autoritetet lokale i japin mundësi Komunitetit të Energjisë të zgjerojë zinxhirin e furnizimit me biomasë bimore që vjen nga mbetjet komunale (degë dhe majat e pemëve të qytetit). Synimi afatshkurtër i radhës është një projekt diellor i përbashkët që synon të mbulojë nevojat e anëtarëve për energji elektrike nëpërmjet matjes virtuale neto dhe matjes neto.





# PYETJE & PËRGJIGJE

## A mund të përshkruani strukturën tuaj organizative dhe modelin e pronësisë?

Kemi një bord drejtues (9 persona) dhe një bord mbikëqyrës (2 persona). Kemi edhe 385 anëtarë të komunitetit dhe të gjithë kanë një votë pavarësisht numrit të aksioneve që kanë në komunitetin e energjisë. Të gjithë anëtarët janë të barabartë. Çdo vit mbahet një asamble e përgjithshme. Çdo 2 vjet mbahen zgjedhje për bordin e administrimit.

## Ndonjë këshillë?

“Të gjithë anëtarët duhet të jenë të barabartë”



© ESEK



**Zelena  
Energetska  
Zadruga**

Božidarevićeva 13, 4.floor,  
10000 Zagreb, Croatia

contact@zez.coop  
+385 1 2095 552

[www.zez.coop](http://www.zez.coop)

### **Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)**

Meshkuj: 45%  
3 vendim marrës  
Gra: 55%  
1 vendim marrës

### **Aktorët kryesorë dhe palët e interesuara (përfshirë partneritetet kryesore)**

Qytetet kroate (Križevci, Velika Gorica, Varaždin, Prelog, Poreč).

Kompanitë diellore (kompanitë e projektimit dhe instalimit).

# **ZEZ (KOOPERATIVA E ENERGJISË SË GJELBËR)**



**KROACI | URBANE | NATIONAL**

NDONJËHERË SHTRIHEMI NË VENDET E EVROPËS LINDORE DHE VENDEVE TË ISH-JUGOSLLAVISË

Kooperativa Green Energy ka përvojë në sektorin e energjisë dhe njohje të lidhjeve komplekse midis energjisë, ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit. Ajo ofron përfshirje aktive të palëve të interesuara, veçanërisht politike bërësve dhe komuniteteve lokale, në proceset e përpunimit dhe zbatimit të politikave.

### **Themelimi (viti)**

2013.

### **Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme**

Diellore.



### **Motivi kryesor (për themelimin)**

Promovimi i kooperativave energjetike si një model për tranzicionin energjetik dhe energjinë e rinovueshme si zgjidhje për krizën energjetike dhe ndryshimet klimatike.

### **Aktivitetet**

Fushat kryesore të aktivitetit të ZEZ-it në burimet e rinovueshme të energjisë dhe efikasitetin e energjisë janë modelet novatore të biznesit dhe mekanizmat financues për nismat lokale të energjisë, pjesëmarrja dhe pronësia e qytetarëve, varfëria energjetike dhe ndërgjegjësimi për politika të ndryshme.

Sot ZEZ është një organizatë ombrellë për sektorin e kooperativave energjetike në Kroaci dhe rajon. Ajo është një partner i asociuar i KIC për Klimën dhe pjesë e qendrës KIC të Klimës në Kroaci dhe, gjithashtu, partner i Qyteteve të Energjisë për promovimin e nismës së Paktit të Kryetarëve të Bashkive në Kroaci dhe rajonin e Ballkanit. ZEZ është gjithashtu anëtare e REScoop.eu. Një aktivitet kryesor është edhe edukimi dhe konsultimi i qytetarëve për energjinë diellore dhe lidhja e tyre me projektuesit dhe instaluesit e projektit.

# PYETJE & PËRGGJIGJE


## A mund të përshkruani strukturën tuaj organizative dhe modelin e pronësisë?

ZEZ është e organizuar si kooperativë me 14 punëdhënës dhe 20 anëtarë të kooperativës.

## Cilën formë ligjore keni zgjedhur?

Kooperativë energjetike jofitimprurëse.

Promovimi i kooperativave energjetike si një model për tranzicionin energjetik dhe energjinë e rinovueshme si zgjidhje për krizën energjetike dhe ndryshimet klimatike.



© ZEZ

## 3

## ANGAZHIMI I PALËVE TË INTERESUARA

**Natyrisht, komunitetet e energjisë duhet të lidhen dhe të angazhojnë një pjesë sa më të madhe të komunitetit ku janë krijuar dhe veprojnë në mënyrë që të realizojnë synimet e tyre. Mënyra se si do t'u drejtoheni njerëzve duhet përcaktuar me kujdes. Si t'i angazhoni ata sa më shumë?**

Individët shpesh anëtarësohen në komunitetet e energjisë për të takuar njerëz me mendime të njëjta. Duke u anëtarësuar, ata ndihen pjesë e një komuniteti në rritje. Duke bashkuar njerëzit, ju mund të shtoni angazhimin, të ndërtoni komunitetin dhe t'u ofroni vlerë anëtarëve tuaj. Kështu që ia vlen të inkurajohet rrjetëzimi dhe ndërveprimi i anëtarëve.

Mos harroni se përfshirja në një projekt komunitar do të thotë të bëhesh një dëgjues shumë i mirë. Nëse doni të kuptoni se çfarë i bën njerëzit të lumtur apo krenarë, çfarë i shqetëson apo i frymëzon, duhet të jeni të aftë për zhvillimin e bisedave joformale që krijojnë ndjeshmëri dhe besim. Kjo do t'ju lejojë të kuptoni në thellësi çështjet më kryesore që prekin jetën e njerëzve.





© REScoop.eu



# MINOAN ENERGY

GREQI | RURAL | RAJONALE



Minoan Energy është komuniteti më i madh energjetik në Greqi. Ai synon të mbështesë qytetarët vendas, NVM-të dhe autoritetet rajonale për të marrë pjesë aktive në tranzicionin e energjisë së rinovueshme në ishullin e Kretës.

## Themelimi (viti)

2019.

## Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

Aktuale: PV (fotovoltaikët).

Të ardhshme: pompimi i ujërave të grumbulluar, erë, biogaz, bateri.



## Motivi kryesor (për themelimin)

Demokratizimi i tranzicionit energjetik në Kretë dhe luajtja e një roli aktiv dhe drejtues në formësimin e politikave rajonale të energjisë.

El. Venizelou 183,  
Arkalochori 703 00, Crete

info@minoanenergy.gr  
+(30) 2891029010

[www.minoanenergy.com](http://www.minoanenergy.com)

## Rolet vendimmarrëse dhe gjinia e ekipit kryesor (për qindja për pozicion)

Bordi i Drejtorëve  
(11 anëtarë, 2 prej të cilëve janë gra) që mbikëqyret dhe konsultohet nga një grup prej 10 personash me përvojë kërkimore, shkencore dhe teknike

Asambleja e Përgjithshme

## Aktorët kyç dhe gupet e interesit (përfshirë edhe partneritetet kryesore)

3 Bashki (Minoa Pediadas, Archanon Asterousion, Viannos) dhe Autoriteti Rajonal i Kretës

Kooperativa e supermarketeve Phaistos

Shërbimet komunale për ujin dhe menaxhimin e ujërave të zeza

Qytetarët

Një kooperativë bujqësore

Familjet me varfëri energjitike

Autoriteti i kishës lokale

## Aktivitetet

Aktualisht, aktivitetet ku Minoan fokusohet përfshijnë: prodhimin, vetë konsumin në kolektiv, edukimin, konsultimin (p.sh., se si anëtarët mund të instalojnë pompat e nxehtësisë). Për më tepër, Minoan Energy eksploron opsionet për përmirësimin e efikasitetit energjetik të ndërtesave komunale.

Në të ardhmen, Minoan dëshiron të fokusohet në shërbime të tilla si: lëvizshmëria elektrike, ngrohja në nivel rrethi, kërkesa-furnizimi, magazinimi.



# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Si i mobilizoni anëtarët tuaj?

Mobilizimi i anëtarëve bëhet me email, telefonata dhe rrjete sociale.

## Si angazhoheni me komunitetin e gjerë rreth nismës suaj?

Programet e financuara nga Evropa mundësojnë seminare të hapura me audiencën e përgjithshme. Më pas, komuniteti më i gjerë arrihet përmes mediave sociale, si dhe përmes intervistave në radio/TV/gazeta dhe media të tjera.

## A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?

Një fushatë që ra veçanërisht në sy lidhte krizën aktuale energjetike me nevojën që qytetarët të prodhojnë energjinë e tyre. Për shembull, presidenti i komunitetit doli në Radio Kreta për një intervistë 2 orëshe në dimrin 2021-2022, e cila u ndoq me interes të gjerë nga audiencia.

## Ndonjë këshillë?

Gjëja më e rëndësishme është të kesh një projekt (pilot) të kompletuar dhe të zbatueshëm për të ardhmen. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohen përfitimet ekonomike. Shohim se ky është motivi kryesor i anëtarësimit të qytetarëve në komunitetet energjetike (përveç aspekteve sociale dhe mjedisore).



© Minoan Energy Community



## ELECTRA ENERGY

GREQI | RURAL / URBANE |  
KOMBËTARE / NDËRKOMBËTARE



Electra Energy është një sipërmarrje sociale që fuqizon qytetarët, bizneset e vogla dhe të mesme për pjesëmarrje aktive në tranzicionin energjetik. Ajo ka dhënë mbështetje për dhjetëra komunitete energjetike në të gjithë Greqinë dhe tani po shtrin aktivitetin e vet në vende të tjera të Ballkanit.

### Themelimi (viti)

2016.

### Motivi kryesor (për themelimin)

Ndihmesa për ta bërë kalimin në energjinë e rinovueshme sa më gjithëpërfshirës dhe të drejtë.

7, Olympionikon Street, Ilioupolis,  
Attica, Greece

contact: Dimitris Kitsikopoulos  
dimitris@electraenergy.coop /  
info@electraenergy.coop  
+30 6973957010

[www.electraenergy.coop](http://www.electraenergy.coop)

### Rolet vendimmarrëse dhe gjinia e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Bordi i Drejtorëve dhe Asambleja e Përgjithshme (vetëm 4 anëtarë, pra janë të njëjtët). Përbërja gjinore: 1 grua, 3 burra. Si bashkë nënshkruese e Deklaratës së Ambicieve Gjinore në Energji të Rescoop.eu, Electra po punon për të arritur barazinë gjinore në Bordin e saj të Drejtorëve deri në vitin 2023.

### Aktorët kryesorë dhe palët e interesuara (përfshirë partneritetet kryesore)

Partnerët rajonalë (laboratori P2P, Greenpeace Greqi, universitete dhe bashki të ndryshme)

Partnerët dhe Rrjetet Kombëtare (Qendra Greke për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, Aleanca Klimatike, Rrjeti Grek për Ekonominë Sociale dhe Solidare)

Rrjetet Ndërkombëtare (REScoop.eu, Qytetet e Energjisë.

### Aktivitetet

Konsulencë, avokim, edukim, kërkim





# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Si i mobilizoni anëtarët tuaj?

### Si angazhoheni me komunitetin e gjerë rreth nismës suaj?

Electra lidhet me audiencën më të gjerë përmes kontakteve të vazhdueshme, ngjarjeve publike, mediave (sociale) dhe komunikimeve një-për-një. Përpara organizimit të një ngjarjeje të hapur, zhvillohet një proces i dedikuar i hartës së palëve të interesuara. Nëpërmjet takimeve dypalëshe, Electra informon palët kryesore të interesit për punën e saj dhe projektet e mundshme të ardhshme për të tërhequr interesin e tyre, por edhe për të mësuar më shumë rreth kontekstit lokal.


## A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?

Electra organizon rregullisht aktivitete publike dhe merr pjesë në forume kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare që kanë lidhje me komunitetet e energjisë. Dy nga fushatat që ka organizuar kanë të bëjnë me: 1) një hartë të ndikimit social të komuniteteve greke të energjisë, 2) një hartë të gjitha komuniteteve ekzistuese të energjisë në Greqi, duke parë gjithashtu karakteristikat specifike si qeverisja, përbërja gjinore, etj.

## A ka ndonjë mjet apo platformë, offline ose online, që përdorni për të promovuar planifikimin dhe angazhimin pjesëmarrës?

### Ndonjë këshillë?

Platforma? *Slack* për komunikim të brendshëm. Ndonjëherë përdorim edhe *Miro*, tabela e bardhë online, për prezantime online. Aktualisht eksperimentojmë me *Loomio* dhe po kontribuojmë në zhvillimin e një platforme qeverisjeje online për komunitetet greke të energjisë.



© Electra Energy cooperative



## WENCOOP

GREQI | RURAL | KOMBËTARE



WenCoop është komuniteti i parë energjetik vetëm me femra në Greqi i themeluar nga Shoqata Greke e Grave Sipërmarrëse.

### Themelimi (viti)

2021.

### Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

Diellore.



### Motivi kryesor (për themelimin)

WenCoop u krijua për të adresuar numrin e ulët të grave në komunitetet ekzistuese të energjisë në Greqi, duke e bërë kështu tranzicionin energjetik më gjithëpërfshirës.

Duke përfituar nga rrjeti ekzistues i Shoqatës Greke të Grave Sipërmarrëse dhe anëtarëve të saj, WenCoop synon të tregojë se si edhe anëtarët pa ekspertizë në çështjet e energjisë mund të përfshihen në tranzicionin e saj.

54626 Thessaloniki, Greece

contact: Alice Corovessi

info@wencoop.gr

+302310 224440

[www.wencoop.gr](http://www.wencoop.gr)

### Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Bordi i Drejtorëve, Asambleja e Përgjithshme dhe Bordi Mbikëqyrës

### Aktorët kryesorë dhe palët e interesuara të përfshira (përfshirë partneritetet kryesore)

Sipërmarrëset femra që i përkasin Shoqatës Greke të Grave Sipërmarrëse (për të qenë anëtare e WenCoop duhet të keni lidhje me sipërmarrjen e femrave si dhe të jeni anëtare e Shoqatës).

### Aktivitetet

Ka përfunduar një park diellor 1 MWp dhe një park i dytë diellor prej 1 MWp është aktualisht në fazën e planifikimit. Të dy këto parqe do të prodhojnë energji që do të shitet në rrjet. Shitja u zgjodh mbi matjen neto për të lejuar pjesëmarrjen kombëtare, pasi anëtarët e Shoqatës Greke të Grave Sipërmarrëse janë të shpërndarë në të gjithë Greqinë.

Aktivitetet e ardhshme: vetëkonsumi.



# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Si i mobilizoni anëtarët tuaj?

Komunikimi i shpeshtë ndërmjet Bordit të Drejtorëve (BD) dhe anëtarëve bëhet së paku një herë në muaj në lidhje me aktivitetet, zhvillimet dhe të gjitha lajmet relevante. Kanalet e komunikimit përfshijnë: e-mail, buletin dhe një sekretar të dedikuar përgjegjës për WenCoop, i disponueshëm sipas kërkesës për pyetje dhe komente. Anëtarët kanë të gjitha kontaktet e bordit të drejtorëve për komunikim të drejtpërdrejtë nëse është e nevojshme.

## A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?

Komunikimi është shumë i synuar për sipërmarrëset femra (në një qasje jo-diskriminuese, çdo formë e sipërmarrjes është e vlefshme) në të gjithë Greqinë. Për sa i përket rrjetëzimit më të gjerë, WenCoop është anëtar i REScoop.eu, në të cilin merr pjesë në grupe pune (si fuqia gjinore dhe avokimi). Është gjithashtu pjesë e grupit kombëtar grek të komuniteteve energjetike të pazhvilluara dhe mban komunikime një-me-një me shumë komunitete energjetike në Greqi.

## A ka ndonjë mjet apo platformë, offline ose online, që përdorni për të promovuar planifikimin dhe angazhimin pjesëmarrës?

Shoqata Greke e Grave Sipërmarrëse shpesh promovon dhe reklamon WenCoop përmes aktiviteteve dhe fushatave të saj. Konkretisht në nëntor 2021 Shoqata organizoi një konferencë rajonale mbi sipërmarrjen femërore në Selanik të Greqisë, ku ndër të tjera, aktivitetet dhe prezantimet e posaçme fokusoheshin tek energjia dhe pjesëmarrja e qytetarëve.

## Ndonjë këshillë?

Përkushtim, punë e palodhur dhe këmbëngulje pavarësisht pengesave që mund të ndodhin rastësisht përgjatë fazave të zhvillimit të projektit.

“WenCoop u krijua për të adresuar numrin e ulët të grave në komunitetet ekzistuese të energjisë në Greqi, duke e bërë kështu tranzicionin energjetik më gjithëpërfshirës.”



© WENcoop

## 4

## AVOKIMI I POLITIKAVE

**Ndërsa shkojmë drejt një sistemi energjetik të bazuar në energjinë e decentralizuar dhe të rinovueshme, peizazhi i politikave, mjediset ligjore dhe rregullatore të së kaluarës kanë nevojë të përditësohen. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që komunitetet e energjisë të bashkojnë forcat dhe të avokojnë për politika që do t'u mundësojnë lindjen, rritjen dhe lulëzimin.**

Që nga fillimi i vitit 2019, grupi i direktivave dhe ligjeve të Bashkimit Evropian i quajtur "Paketa e Energjisë së Pastër për të Gjithë Evropianët" u jep të drejtën qytetarëve që të marrin pronësinë e projekteve të tranzicionit të energjisë përmes komuniteteve energjetike. Kjo rregullore e re evropiane i njeh qytetarët si aktorë të rëndësishëm në tregun e energjisë dhe përshkruan parimet dhe aktivitetet e qeverisjes për komunitetet energjetike. Njerëzit, autoritetet lokale dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) mund të krijojnë subjekte juridike që duhet të mbështeten nga qeveritë e tyre kombëtare. Këto direktiva janë të rëndësishme edhe për vendet jashtë BE-së në Ballkan, pasi duke qenë pjesë e "Komunitetit të Energjisë" të BE-së dhe vendeve fqinje,<sup>2</sup> këto vende i zbatojnë direktiva, ndonëse pa i kthyer në një kërkesë të detyrueshme përmes transpozimit.




© REScoop.eu

Ndërmerrni hapa për të qenë të sigurt se zëri juaj do të dëgjohej dhe mendimi juaj do të vihet në jetë sa më mirë që të jetë e mundur. Qeveritë kombëtare, rajonale dhe lokale duhet të shkojnë përtej konsultimeve të thjeshta dhe të përfshijnë sinqerisht qytetarët në planet e tyre të tranzicionit energjetik. Bashkohuni me grupe të ngjashme në vendet e tjera dhe shkëmbeni përvojat më të mira. Sigurohuni që të gjitha informacionet, përvojat e mira dhe të këqija t'i bëhen të njohura BE-së me qëllim garantimin e monitorimit dhe zbatimit të duhur të gjitha dispozitave të transpozuar të energjisë qytetare.



© REScoop.eu

<sup>2</sup> <https://www.energy-community.org/aboutus/whoweare.html>



El. Venizelou 183,  
Arkalochori 703 00, Crete  
info@minoanenergy.gr  
+(30) 2891029010

[www.minoanenergy.com](http://www.minoanenergy.com)

# MINOAN ENERGY

GREQI | RURAL | RAJONALE



## PYETJE & PËRGJIGJE

### Cila është përfshirja juaj në avokimin e politikave?

Përmes pjesëmarrjes në organizatën që po krijohet *Greek national cluster of energy communities* e cila ka hartuar dy letra drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Mjedisit ku përshkruhen të metat dhe fushat e mundshme për përmirësime në legjislacionin aktual grek të energjisë për temën e komuniteteve energjetike. Gjithashtu, edhe përmes lobimit kokë më kokë me deputetët, autoritetin rajonal të Kretës dhe kryetarët e bashkive, ministrat dhe figurat e tjera kryesore politike.

### Çfarë keni mbrojtur dhe si?

Kryesisht promovimi i një kuadri ligjor mundësues, të drejtë dhe mbështetës, për komunitetet energjetike - p.sh., dhënia e granteve për komunitetet e përfshira në aktivitetet e matjes neto dhe heqja e shpenzimeve të panevojshme si dhe procedurave burokratike për komunitetet e energjisë, p.sh., proceset e tenderimit.

### A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?

Letrat avokuese të përgatitura së bashku me grupin e komunitetit energjetik grek, por edhe letrat të veçanta nga komuniteti për figura të ndryshme politike. Avokimi është i përfshirë në të gjitha seminarët dhe veprimtaritë e tjera me audiencë të përgjithshme.

### Ndonjë këshillë?

Rrjetëzimi dhe koalicionet janë mënyra më e mirë për të ushtruar presion kolektiv dhe për të siguruar më shumë ndikim dhe forcë.



## ELECTRA ENERGY

GREQI | RURAL / URBANE |  
KOMBËTARE / NDËRKOMBËTARE



## PYETJE & PËRGGJIGJE

### Cili është përfshirja juaj në avokimin e politikave?

Electra është aktive në avokimin e politikave dhe ka një përfshirje të vazhdueshme përmes: 1) takimeve individuale me përfaqësuesit politikë dhe partitë politike, 2) konferencave të mediave dhe shtypit, 3) letrave të hapura, 4) edukimit të publikut të gjerë, 5) rrjetëzimit për të ushtruar presion kolektiv

### Çfarë keni mbrojtur dhe si?

Electra ka mbrojtur një kuadër ligjor të drejtë dhe mbështetës për komunitetet greke të energjisë. Ajo gjithashtu punon për të parandaluar kooptimin e ligjit për komunitetet energjetike nga subjektet private, fitimprurëse, dhe në këtë mënyrë të garantojë që kuadri ligjor të mbetet pa asnjë lëkundje pjesë e ekonomisë sociale dhe solidare.

### A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?

Krijimi i grupit të parë të komuniteteve energjetike greke, përmes të cilit anëtarët hartuan një letër kolektive në shkurt 2021, duke kërkuar ndryshime specifike në kuadrin ligjor për komunitetet energjetike. Një version i përditësuar i kësaj letre, duke iu përgjigjur gjithashtu çështjeve aktuale (si kriza energjetike dhe udhëzimet e reja të BE-së në lidhje me Ndhmën Shtetërore për komunitetet energjetike) u dërgua në prill 2022.


### Ndonjë këshillë?

Avokimi është kyç për të garantuar që ligji u jep të drejtë qytetarëve të marrin pjesë në tranzicionin e energjisë. Avokimi efektiv mund të vijë përmes rrjetëzimit. Duke formuar një koalicion të aktorëve të energjisë në komunitet, si dhe aktorëve të tjerë që punojnë në sektorë të ndryshëm socialë dhe mjedisorë, mund të ushtrohet presion kolektiv dhe të dëgjohet zëri i komuniteteve të energjisë.

7, Olympionikon Street, Ilioupolis,  
Attica, Greece

contact: Dimitris Kitsikopoulos  
dimitris@electraenergy.coop /  
info@electraenergy.coop  
+30 6973957010

[www.electraenergy.coop](http://www.electraenergy.coop)



**Zelena  
Energetska  
Zadruga**

# ZEZ (GREEN ENERGY COOPERATIVE)

KROACI | URBANE | KOMBËTARE



## PYETJE & PËRGJIGJE

### **Cila është përfshirja juaj në avokimin e politikave?**

Në çdo ligj të ardhshëm për energjinë, klimën apo komunitetet energjetike, ZEZ është aktive në procesin e konsultimit publik të ligjit. Kemi organizuar seminare me palët përkatëse të interesit për temën e komuniteteve energjetike.

### **Për çfarë keni avokuar dhe si?**

Fokusi i avokimit të politikave të ZEZ është tek energjia e rinovueshme, në përgjithësi, dhe komunitetet e energjisë, në veçanti.

### **A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?**

Dy fushata të suksesshme që ZEZ ka organizuar janë:

- i) Turi i energjisë së mirë – promovimi i energjisë diellore tek qytetarët;
- ii) Laboratori i politikave – diskutim për komunitetet energjetike dhe legjislaionin përkatës.

Božidarevićeva 13, 4.floor,  
10000 Zagreb, Croatia

contact@zez.coop  
+385 1 2095 552

[www.zez.coop](http://www.zez.coop)



# ENERGY COOPERATIVE ELEKTROPIONIR



SERBI | RURAL / URBANE | KOMBËTARE

Elektropionir është një komunitet energjetik serb i krijuar në dhjetor 2019 nga një grup mbështetësish të përfshirë në prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe mënyrat novatore të organizimit qytetar. Ata synojnë të fuqizojnë qytetarët për pjesëmarrjen aktive në tranzicionin energjetik në Serbi dhe të demonstrojnë se është e mundur të prodhohet energji elektrike në rrugë të qëndrueshme mjedisore dhe ekonomike sipas parimeve të funksionimit të kooperativave.

## Themelimi (viti)

2019.



## Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

Diellore (deri tani).

## Motivi kryesor (për themelimin)

Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike në pronësi të qytetarëve.

info@elektropionir.rs

[www.elektropionir.rs](http://www.elektropionir.rs)

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Vendimmarrje bashkëpunuese dhe demokratike - një anëtar një votë. Drejtuese femra (themeluese dhe aktuale), kryesimi i asamblesë nga një grua.


## Aktorët kryesorë dhe palët e interesuara të përfshira (përfshirë partneritetet kryesore)

Palët e interesuara: Ministria Serbe e Minierave dhe Energjisë, OSSH Serbe. Aleatët: kooperativa të tjera energjetike (në Serbi dhe në rajon), Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Serbisë, zhvilluesit e projekteve të PV diellore, organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve, konsumatorët e organizuar në mënyrë jo-formale, OJQ-të e gjelbra.

## Aktivitetet

Edukim, fushata financimi nga publiku, advokaci, prodhimi i energjisë elektrike (në vazhdim).





# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Cili është përfshirja juaj në avokimin e politikave?

Komentimi dhe ndikimi i drafteve të ndryshimeve në Ligjin për Energjinë dhe Ligjin e ri për Përdorimin e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, Ligjin për Eficiencën e Energjisë dhe për Përdorimin Racional të Energjisë (të gjitha në 2021). Komentimi dhe ndikimi i drafteve të akteve nënligjore në lidhje me prosumatorët. Reagimi ndaj problematikave në zbatimin e këtyre akteve nënligjore.

## Çfarë keni mbrojtur dhe si?

Kemi mbrojtur heqjen e të gjitha barrierave financiare dhe administrative për vendosjen e FV-ve në çati nga prosumatorët e ardhshëm. Avokojmë nëpërmjet një rrjeti aleatësh brenda qeverisë dhe industrisë. Planifikojmë të avokojmë për zbatimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të Komuniteteve BRE (transpozuar nga RED II).

## A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar?

Komentimi i drafteve legjislativë, takimet konsultative me aleatët dhe ekspertët për të zhvilluar propozime dhe komente politikash, takime avokuese me zyrtarë të qeverisë, dhe pjesëmarrja në aktivitete me qeverinë drejtuesit e shërbimeve publike në pronësi të shtetit.



© Elektropionir

## 5

PARTNERITETET  
& RRJETET

**Për t'u rritur e forcuar, komunitetet e energjisë duhet të ndërtojnë partneritete me aktorë lokalë ose translokalë. Bashkitë janë shpesh aleatët e parë, mbështetësit kryesorë dhe shpesh anëtarë të komuniteteve energjetike. Komunitat janë niveli i parë i përfaqësimit të qytetarëve, por jo rrallë u mungojnë aftësitë dhe mjetet për t'u angazhuar me qytetarët e tyre. Shpesh kanë vështirësi të kalojnë nga idetë në veprim. Duke bashkuar forcat, nismat qytetare dhe bashkitë mund së bashku mund të çojnë përpara tranzicionin energjetik në kushtet e tyre.**

Komunitetet energjetike, gjithashtu, mund të organizojnë dhe zhvillojnë rrjete ose federata kombëtare, të cilat mund të ndihmojnë jo vetëm në drejtim të avokimit të politikave, por edhe në drejtim të zhvillimit të projekteve, financimit, ndërtimit të komunitetit, komunikimit, etj. Shpesh rrjetet kombëtare mbështesin anëtarët e tyre me licencim ose këshilla financimi, ndër shërbimet e tjera, me tarifë të ulët, ose falas, në rastet kur projekti i tyre nuk kualifikohet (si në rastin e *Energie Samen* në Holandë).

Ndër të tjera, komunitetet energjetike përfitojnë edhe nga ndërtimi i partneriteteve me disa nga OJQ-të që ndjekin politika të ngjashme. Bashkimi i forcave me organizata me përvojë në organizimin e fushatave dhe avokimin e politikave mund të ndihmojë në përcjelljen e mesazhit të tyre për t'u lidhur dhe rritur ndërgjegjësimin e segmenteve të gjera të shoqërisë, njëherazi duke ushtruar më shumë presion ndaj politikë bërësve në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.



© Electra Energy Cooperative & REScoop.eu



## KOALICIONI PËR ENERGJINË E KOMUNITETIT

Koalicioni për Energjinë e Komunitetit bashkon një rrjet të larmishëm organizatash me të njëjtin qëndrim dhe me objektivin e përbashkët për të promovuar pronësinë e qytetarëve dhe komunitetit të energjisë në transformimin urgjent drejt një sistemi 100% të energjisë së rinovueshme. Koalicioni përfshin shoqata që përfaqësojnë kooperativat energjetike, rrjetet e qyteteve dhe autoriteteve lokale, industrinë e energjisë së rinovueshme, ekspertë ligjorë dhe OJQ të ndryshme mjedisore.

### Vlerat tona të përbashkëta

Sistemi aktual energjetik i Evropës, i cili dominohet nga një numër i vogël i ndërmarrjeve të mëdha, përbën mbi 30% të emetimeve të përgjithshme të gazrave serë në Evropë. Për të adresuar sfidat globale, të tilla si ndryshimet klimatike dhe pabarazitë socio-ekonomike, sistemi i ardhshëm energjetik i Evropës duhet të jetë i qëndrueshëm, pa karbon, shoqërisht i drejtë, në pronësi publike dhe i kontrolluar nga njerëzit dhe komunitetet vendase. Ne besojmë se një sistem i decentralizuar dhe 100% i energjisë së rinovueshme është i mundshëm dhe i nevojshëm - ndërkohë që edhe kërkesa jonë për energji duhet të ulët. Ne kërkojmë t'i jepet fund kontrollit mbi sistemet tona energjetike nga një grusht ndërmarrjesh të mëdha dhe kërkojmë që qytetarët e BE-së të vihen në qendër të transformimit tonë energjetik.

Potenciali që njerëzit - individualisht dhe përmes komunitetit të tyre, enteve publike dhe ndërmarrjeve të vogla - të përfshihen në mënyrë aktive në tranzicionin e energjisë, është i qenësishëm. Deri në vitin 2050, të paktën gjysma e qytetarëve të BE-së mund të prodhojnë energjinë e tyre të rinovueshme, duke plotësuar të paktën 45% të kërkesës për energji elektrike të BE-së.

Koalicioni për Energjinë e Komunitetit beson në projektet energjetike në pronësi lokale dhe publike që synojnë të adresojnë nevojat socio-ekonomike në nivel vendor, bazuar në anëtarësimin vullnetar dhe të hapur, kontrollin demokratik, pjesëmarrjen ekonomike të secilit anëtar dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve. Pronësia e komunitetit i fuqizon qytetarët të marrin vendime për të ardhmen e tyre energjetike. Pronësia e komunitetit në prodhimin e energjisë së rinovueshme shërben për të mbajtur përfitimet nga burimet e rinovueshme në nivel vendor për krijimin e vendeve të punës, nxitjen e investimeve lokale, ofrimin e shërbimeve të tilla si arsimit, duke inkurajuar qytetarët të kursejnë energjinë dhe duke luftuar varfërinë energjetike. Përmes nxitjes së anëtarëve që të kalojnë në burime të rinovueshme, komunitetet e energjisë mund t'i bashkojnë njerëzit për të përfituar si ata vetë, ashtu edhe sistemi energjetik. Potenciali i komuniteteve të energjisë nuk qëndron vetëm në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë së rinovueshme, por edhe në nxitjen e kursimit të energjisë.

Qasjet e bazuara në treg, të vetme, janë të pamjaftueshme për të nxitur tranzicionin e suksesshëm të energjisë. Burimet e rinovueshme të energjisë janë mallra të përbashkëta dhe të gjithë qytetarët duhet të kenë mundësi të barabarta për pronësi dhe për të përfituar nga pjesëmarrja në tranzicionin energjetik. Për më tepër, tranzicioni i energjisë duhet të bazohet në drejtësi dhe solidaritet ku askush nuk duhet të mbetet pas, përfshirë familjet e cenueshme dhe në varfëri energjike.

**Mëso më shumë:** [https://communitypowercoalition.eu/community\\_power\\_booklet\\_v5-screen.pdf](https://communitypowercoalition.eu/community_power_booklet_v5-screen.pdf)



# CHALKI ENERGY COMMUNITY

**GREQI** | RURAL (ISHULL) | RAJON (ISHULL)



Chalki ka nënshkruar Paktin e Kryetarëve të Bashkive dhe planin e tranzicionit të energjisë. Në këtë kontekst, ata kanë vendosur të formojnë një komunitet energjetik që do të përfshijë gjerësisht shoqërinë vendore. Ai përbëhet nga më shumë se 150 anëtarë me qëllimin përfundimtar për të përfshirë të gjithë në ishull, duke përfshirë familjet e varfra në energji pa pagesë.

## Themelimi (viti)

2021.



## Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

FV diellore. Aktualisht po përgatiten studimet e fizibilitetit për shfrytëzimin e energjisë së valëve (një park 1 MW).

## Motivi kryesor (për themelimin)

Motivi kryesor i Komunitetit Energjetik Chalki është përfshirja e çdo banori vendas të ishullit në tranzicionin energjetik. Qëllimi është përsheptimi dhe demokratizimi i tranzicionit të energjisë. Promovimi i praktikave të drejtpërdrejta demokratike për planifikimin e ardhshëm të energjisë.

contact: Vasilis Roussakis,  
Vice Mayor of Chalki  
vasillys@hotmail.com  
+306944995011

[www.chalkion.gr](http://www.chalkion.gr)

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (për qindja për pozicion)

Bordi i Drejtorëve (5 anëtarë, të gjithë burra) dhe Asambleja e Përgjithshme.

## Aktorët kryesorë dhe palët e interesuara (përfshirë partneritetet kryesore)

Bashkia vendore

Qytetarët

Familjet e varfra në energji

Bizneset e vogla dhe të mesme lokale.

## Aktivitetet

Aktiviteti kryesor i Komunitetit Energjetik Chalki është vetë-konsumi kolektiv përmes një parku diellor 1 MW. Gjithashtu, përdorimi i mjeteve elektrike nga qytetarët dhe stafi i Bashkisë. Anëtarët e komunitetit të energjisë po marrin pjesë në aktivitete edukative me nxënës të shkollës së mesme lokale.

Planifikimi i vënies në punë të një varke publike që do të furnizohet me energji të rinovueshme.



# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Çfarë partneritetesh keni ndërtuar?

Bashkia Chalki ka përfituar asistencë informative dhe teknike nga aktorë të tjerë të energjisë ishullore. Ajo ka përfituar edhe ndihmë të posaçme nga Electra Energy Cooperative.

## Si është bashkëpunimi juaj me bashkinë deri tani?

Bashkia është anëtar qendror i komunitetit. Ajo përdor një pjesë të energjisë të prodhuar diellore për të mbuluar nevojat komunale për energji elektrike dhe në këtë

mënyrë ul kostot e energjisë elektrike për qytetarët vendas (p.sh., përmes implantit lokal të shkripëzimit). Bashkia, gjithashtu, kontribuon me këshilla dhe avokim juridik dhe politik.

## A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar në partneritet?

Komuniteti i energjisë funksionon si një pikë ndërlidhëse, duke organizuar aktivitete të shumta mjedisore dhe sociale, siç është rasti i një fushate avokimi për pakësimin e plastikës.

## Ndonjë këshillë?

Vazhdoni të avokoni për kalimin në energjinë e pastër. Duke u organizuar si pjesë e komunitetit, ngrini zërin dhe ndihmoni në përforsimin e mesazhit.



© Chalki Energy Community



# MINOAN ENERGY

GREQI | RURAL | RAJONALE



## PYETJE & PËRGGJIGJE

### Si është bashkëpunimi juaj me bashkinë deri më tani?

Bashkitë i kanë dhënë ndihmesë Minoan-it duke i siguruar toka (me qira) me çmime relativisht të ulëta, si dhe kanë ofruar edhe mbështetje politike për komunitetin.

Autoriteti Rajonal ka qenë vazhdimisht mbështetës, pasi po planifikon të financojë disa programe të shtrirjes të komunitetit dhe mund të financojë potencialisht studimet e fizibilitetit për një projekt të depozitimit të hidrocentraleve me pompa.

### Si është bashkëpunimi juaj me nisma të tjera ishullore/kombëtare?

Ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm me komunitetet e energjisë në ishujt Samos, Chalki, Sifnos, Kasos, Simi dhe Chios, i cili përfshin shtrirjen, ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen teknike.

### A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar në partneritet?

Parku aktual fotovoltaiq që po projektohet me kapacitet 1 MW do të përfshijë pa pagesë 60 familje në disavantazh. Nga këto 50 do të subvencionohen nga Autoriteti Rajonal dhe 10 nga anëtarët e tjerë të komunitetit.

### Ndonjë këshillë?

Është e rëndësishme që autoritetet lokale të binden për përfitimet sociale, mjedisore dhe ekonomike të projektit dhe për potencialin që ai gjeneron për sinergji dhe zhvillim lokal. Është gjithashtu thelbësore të formohet një ekip themelues i fortë, i cili të ketë aftësi, njohuri, të punojë në mënyrë transparente dhe të ketë një qëndrim të fortë shoqëror, si dhe besim në komunitetin lokal.

El. Venizelou 183,  
Arkalochori 703 00, Crete

info@minoanenergy.gr  
+(30) 2891029010

[www.minoanenergy.com](http://www.minoanenergy.com)



**Zelena  
Energetska  
Zadruga**

## **ZEZ (GREEN ENERGY COOPERATIVE)**

**KROACI | URBANE | KOMBËTARE**



### **PYETJE & PËRGJIGJE**

**Çfarë partneriteti keni ndërtuar?  
Si është bashkëpunimi juaj me  
autoritetet lokale deri më tani?**

**Si është bashkëpunimi juaj me  
nisma nga vendet fqinje të  
Ballkanit?**

**A mund të përshkruani disa  
aktivitete/fushata që keni  
organizuar në partneritet?**

Kemi projekte të ndryshme që adresojnë komunitetet e energjisë në zonën e Ballkanit.

Božidarevićeva 13, 4.floor,  
10000 Zagreb, Croatia

contact@zez.coop  
+385 1 2095 552

[www.zez.coop](http://www.zez.coop)

Sot ZEZ është një organizatë ombrellë për sektorin e kooperativës energjetike në Kroaci dhe rajon, partner i asociuar i Climate KIC dhe pjesë e qendrës kroate të Climate KIC, dhe gjithashtu partner i qyteteve energjetike për promovimin e nismës së Paktit të Kryetarëve të Bashkive në Kroaci dhe rajon. ZEZ është gjithashtu anëtare e REScoop.eu, federatës evropiane të kooperativave energjetike për qytetarët. Ne bashkëpunojmë me qytetet kroate mbi projekte të ndryshme.



# ENERGY COOPERATIVE ELEKTROPIONIR



SERBI | RURAL / URBANE | KOMBËTARE

## PYETJE & PËRGGJIGJE

### Çfarë partneriteti keni ndërtuar?

Ne kemi zhvilluar partneritete me aktorë të ndryshëm, si Ministria e Minerave dhe Energjisë së Serbisë, OSSH-ja e Serbisë, kooperativa të tjera energjetike (në Serbi dhe në rajon), Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Serbisë, zhvilluesit e projekteve fotovoltaike diellore, organizatat e mbrojtjes së konsumatorit, prosumatorët e organizuar në mënyrë joformale dhe OJQ-të e gjelbra. Partneriteti ndoshta më interesant, është me një organizatë për mbrojtjen e konsumatorit që na ndihmon të zgjidhim problemet që hasin prosumatorët, si dhe problemet me vetë prosumatorët e organizuar në mënyrë joformale.

### Si është bashkëpunimi juaj me nisma nga vendet fqinje të Ballkanit?

Ne kemi një lidhje aktive me Kooperativën e Energjisë së Gjelbër (ZEZ) nga Kroacia.

### A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar në partneritet?

Të gjitha aktivitetet tona të mbështetjes së politikave, kryhen në partneritet. Së paku me një kooperativë tjetër energjetike, përkatësisht, Sunčani krovovi Šabac

info@elektropionir.rs

[www.elektropionir.rs](http://www.elektropionir.rs)





7, Olympionikon Street, Ilioupolis,  
Attica, Greece

contact: Dimitris Kitsikopoulos  
dimitris@electraenergy.coop /  
info@electraenergy.coop  
+30 6973957010

[www.electraenergy.coop](http://www.electraenergy.coop)

## PYETJE & PËRGJIGJE

### Çfarë partneriteti keni ndërtuar?

Përtej grupit kombëtar grek të komuniteteve energjetike, i cili bashkon shumicën e komuniteteve autentike energjetike të Greqisë, Electra është vendosur si një ndërmjetës qendror i ekosistemit energjetik të komunitetit grek. Ajo po punon me SME-të, organizatat kulturore, bashkitë, grupet e aktivistëve, individët dhe lloje të ndryshme kooperativash (p.sh., farmacitë dhe kooperativat bujqësore). Gjithashtu po zgjeron gjithnjë e më shumë shtrirjen e saj në Evropën kontinentale, si dhe në rajonin e Ballkanit dhe Evropën Juglindore (Qipro, Turqi dhe Maltë).

## ELECTRA ENERGY

GREECE | RURAL / URBANE |  
KOMBËTARE / NDËRKOMBËTARE



### Si është bashkëpunimi juaj me nisma të tjera ishullore/kombëtare?

Electra ofron një mbështetje tërësore, duke përfshirë konsulencën teknike, ligjore, financiare dhe konsulencë të përgjithshme, si dhe ndihmon komunitetet e tjera të kenë akses në burimet përkatëse, të lidhen me palët e tjera të interesit dhe të marrin pjesë në rrjetet kombëtare dhe evropiane.

### Cili është progresi kur bëhet fjalë për ndërtimin e një federate kombëtare?

Progresi me federatën kombëtare ka qenë i ngadaltë, pasi kërkon që dikush të marrë drejtimin aktiv për të nxitur iniciativat, duke qenë se nuk ka personel apo financim të dedikuar për këtë. Megjithatë, Electra beson me vendosmëri se federata ka zhvilluar tashmë aksione të rëndësishme ndërgjegjësuese dhe përkrahëse.

### Si është bashkëpunimi juaj me nisma nga vendet fqinje të Ballkanit?

Gjithnjë e më shumë duke u konsoliduar, ekosistemi i komunitetit të energjisë në Ballkan po fillon të dalë në pah vetëm tani, dhe modelet e ndryshme të biznesit janë të rastësishme dhe ndonjëherë të vështira për t'u deshifruar. Megjithatë, ka një potencial të mjaftueshëm për Ballkanin që të kalojë drejtpërdrejt nga lëndët djegëse fosile, në

energjinë e rinovueshme të decentralizuar, që drejtohet nga prosumatorët e licencuar.

### A mund të përshkruani disa aktivitete/fushata që keni organizuar në partneritet?

Në fund të qershorit të vitit 2022, Electra bashkorganizoi një Shkollë Verore të Energjisë së Komunitetit në Selanik, Greqi. Kjo mbledhi bashkë 150 palë interesi nga secili nga vendet në Ballkan dhe Evropën Juglindore dhe shënoi fillimin e një diskutimi më të gjerë drejt krijimit të një Rrjeti të Energjisë së Komunitetit Ballkanik.

Electra ka kryer gjithashtu vizita bashkëpunimi në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, duke punuar me OJQ-të dhe bashkitë, për t'i ndihmuar ato të krijojnë grupe të energjisë në komunitet.

### Ndonjë këshillë?

Vendet e Ballkanit mund të mësojnë nga njëri-tjetri për të shmangur gabimet e së kaluarës dhe për të kapur mundësitë. Për shembull, ato duhet të bëjnë transpozimin e plotë të Direktivave të Paketës së Energjisë së Pastër për të gjithë evropianët, në mënyrë që të njohin komunitetet e energjisë në legjislacionin kombëtar, por edhe të vendosin kritere të rrepta përkufizimi për të shmangur diversionin nga interesat private. Puna së bashku, mund të forcojë zërin e të gjithëve përmes aksioneve të mbështetjes kolektive.

## 6

## FINANCIMI

Financimi është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen komunitetet e energjisë. Tejkalimi i barrierave financiare, kërkon një përzierje të qasjeve novatore dhe mjeteve ekzistuese. Projektet e komuniteteve të energjisë, financohen përgjithësisht nga qytetarët. Shumë prej këtyre angazhohen në crowdfunding (mbledhjen e fondeve online), për të mundësuar fonde direkt nga komuniteti i tyre. Komunitetet më të avancuara të energjisë, ndonjëherë përdorin edhe huatë bankare. Aksesimi në financim nëpërmjet huave bankare, nuk është gjithmonë i lehtë, pasi ato kërkojnë garanci.

## CROWDFUNDING - MBLEDHJA E FONDEVE NË INTERNET

*Crowdfunding* është një mënyrë për të mbledhur para për të mundësuar financimin e projekteve dhe bizneseve. Mund të jetë një mënyrë e shkëlqyer për të fuqizuar komunitetin më të gjerë, që të marrë pjesë aktive në kauzat në të cilat beson dhe t'i mbështesë ato. Crowdfunding u mundëson mbledhësve të fondeve të sigurojnë para nga një numër i madh njerëzish përmes platformave online. Ekzistojnë tre lloje të kthimeve të crowdfunding: interesi, kapitali dhe shpërblime të tjera.

Çdo aktivitet crowdfunding do të përfitojë nga përgatitja e mirë. Gjëja e rëndësishme është të zgjidhni një platformë të mirë online të crowdfunding (ose të krijoni tuajën) dhe të paraqisni një histori bindëse dhe transparente.



© Hyperion Energy Community



## KA DISA MUNDËSI TË NDRYSHME TË LIDHURA ME MODELIN E CROWDFUNDING:

- **Huadhënie nga njëri-tjetri (crowdlending)** – Investitorë të shumtë privatë japin para hua duke ditur se paratë do t'u rikthehen me interes. Është shumë e ngjashme me huamarrjen tradicionale bankare, me dallimin se ju merrni hua nga shumë investitorë.
- **Crowdfunding i bazuar në shpërblime** – Individët dhurojnë për projektin me pritshmërinë për të marrë në këmbim të kontributit të tyre, shpërblime jofinanciare, të tilla si mallra apo shërbime, në një fazë të mëvonshme.
- **Crowdfunding i bazuar në donacione** – Individët dhurojnë shuma të vogla për të përbushur qëllimin më të madh të financimit, duke mos marrë asnjë kthim financiar ose material.
- **Ndarja e fitimeve/ndarja e të ardhurave** – Projekti i komunitetit mund të ndajë fitimet ose të ardhurat e ardhshme me grupin, në këmbim të financimit në moment.
- **Modelet hibride** – U ofrojnë bizneseve mundësinë të kombinojnë elemente të më shumë se një lloji të financimit crowdfunding.

Ekzistojnë forma të tjera të crowdfunding, si siguria e borxhit dhe financimi i kapitalit. Crowdfunding është relativisht i ngjashëm me ofertën e aksioneve, me përjashtim të disa pikave të rëndësishme: së pari, shpesh është një proces më i lehtë. Kërkesat administrative (të tilla si publikimi i prospektit) zakonisht nuk ekzistojnë ose reciprokohen nga platforma. Së dyti, crowdfunding bën të mundur mbledhjen e financimeve edhe nga persona privatë. Kësaj i referohemi më saktësisht me termin crowdlending (huadhënie nga shumë persona). Prandaj, është e rëndësishme të theksohet ndryshimi mes ofertës së aksioneve, që e pajis anëtarin tuaj me të drejta dhe kontroll të anëtarësimit, dhe crowdlending që fokusohet në kthimet financiare.

Crowdfunding kalon përmes një platforme në internet në mënyrë që të arrijë një numër maksimal pjesëmarrësish. Ekzistojnë shumë **platforma**. Për të gjetur një platformë të përshtatshme, kriteret për t'u marrë parasysh janë:

- **Specifikimet e platformës:** disa platforma janë të specializuara në llojet e projekteve.
- **Popullariteti në shkallën e nevojshme:** është e rëndësishme të gjenden platforma që kanë numrin maksimal të përdoruesve bazuar në fushëveprimin gjeografik të dëshiruar nga projekti (rajonal, kombëtar, evropian).
- **Tarifat dhe skemat e shpërblimit:** jini gjithmonë të vetëdijshëm për tarifën e platformës (tarifat fikse ose komisione, janë më të zakonshmet) dhe kufijtë e kapitalit.
- **Rregullat dhe rregulloret kombëtare:** jini të vetëdijshëm për rregullat, shumë Shtete Anëtare kanë aplikuar rregulla të rrepta për mbrojtjen e investitorëve privatë.
- **Selia qendrore:** është paraja që udhëton dhe ku ruhet nga platforma, kriteret këto që duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së një platforme të sigurt.
- **Veçoritë:** merrni parasysh veçoritë e ndryshme që do t'ju nevojiten për të drejtuar një fushatë të suksesshme të mbledhjes së fondeve.

Mos hezitoni të intervistoni një përfaqësues nga disa platforma të ndryshme, për t'u siguruar që keni gjetur partnerin e duhur dhe që keni identifikuar qartë hapat e nevojshëm për të nisur fushatën tuaj të crowdfunding (dokumentet financiare dhe ligjore, kontaktet dhe ekipet e mbështetjes së platformës).

Kooperativa të ndryshme krijuan gjithashtu platformat e tyre të crowdfunding. Ky është rasti i Genervest në Greqi, por edhe i Coopernico (Portugali) dhe ZEZ (Kroaci) nga projekti COMPILE. Më poshtë, paraqesim disa shembuj të praktikave të këtyre kooperativave.

**Zbuloni më shumë në:** <https://www.compile-project.eu/products/coolkit/financing/>



7, Olympionikon Street  
PC 16342, Athens, Greece

contact: Chris Vrettos  
chris@electraenergy.coop  
+306948387911

[www.electraenergy.coop/here-comes-the-sun-first-community-solar-farm-in-greece/](http://www.electraenergy.coop/here-comes-the-sun-first-community-solar-farm-in-greece/)

[www.hyperioncommunity.com](http://www.hyperioncommunity.com)

### Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Hyperion ka Bordin e Drejtorëve dhe Asamblenë e Përgjithshme si dy degët e saj ekzekutive. Bordi i përkohshëm i Drejtorëve përbëhet nga 3 anëtarë, të tre burra. Megjithatë, zgjedhjet do të mbahen brenda vitit 2022 dhe duke qenë se Hyperion është bashkë-nënshkrues i Deklaratës së Ambicieve të Fuqisë Gjinore të Rescoop.eu, ata janë të përkushtuar që të kenë përfaqësim të barabartë gjinor në Bordin e tyre të ardhshëm të Drejtorëve.

# HYPERION

GREQI | URBANE | RAJONALE / KOMBËTARE



Hyperion është një komunitet energjetik, pa qëllim fitimi, me seli në Athinë, Greqi.

### Shtrirja gjeografike (rajonale/kombëtare)


Rajonale, por replikimi dhe ngritja e kapaciteteve për nismat e komuniteteve të reja, ndodhin në nivel kombëtar.

### Themelimi (viti)

2019.

### Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

Energji diellore.



### Motivi kryesor (për themelimin)

Krijimi i një modeli të qëndrueshëm dhe të replikueshëm të vetëkonsumimit kolektiv. Hyperion synon të jetë një projekt nxitës për demokracinë energjetike në Greqi.

### Aktorët kryesorë dhe palët e interesit të përfshira (përfshirë partneritetet kryesore)

Qytetarët, familjet me varfëri energjetike që përfitojnë nga parku diellor kolektiv

### Aktivitetet

Vetëkonsum kolektiv përmes matjes virtuale neto. Përveç kësaj, aktivitete edukative dhe të ndërtimit të ekipit. Projektet e ardhshme: efikasiteti i energjisë, lëvizshmëria elektrike, përgjigjja ndaj kërkesës dhe depozitimi.



# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Si e keni financuar projektin tuaj?

Kryesisht përmes pjesëmarrjes së kapitalit të anëtarëve. Gjithashtu, disa donacione në kuadër të një crowdfunding shumë të vogël për të subvencionuar kostot e anëtarësimit të disa familjeve me varfëri energjetike. Së fundi, Hyperion organizoi një fushatë crowdfunding përmes platformës së investimeve të *Genervest* për të ofruar mikro-kredi me normë interesi të ulët nga disa prej anëtarëve.

## Si e organizuat aksionin tuaj të crowdfunding?

Fushata crowdfunding u organizua në koordinim me Genervest dhe Greenpeace Greece, të cilët ndihmuan në shtrirjen e mediave. Anëtarët u përfshinë tërësisht në analizën e përfitimeve (dhe kostove) të marrjes së një huaje dhe gjatë Asamblesë së Përgjithshme ata vendosën të procedonin me një votë pozitive.

## Cilën platformë keni përdorur? Përse?

Genervest.org - lejon investime mikro dhe të mesme në projekte të energjisë së rinovueshme që gjithashtu kanë një lloj ndikimi social, p.sh. komunitetet e energjisë.

## Ndonjë këshillë?

Një fushatë e suksesshme crowdfunding duhet të ndërtojë një narrativë që i përgjigjet ngjarjeve aktuale (p.sh., kriza aktuale e energjisë), dhe gjithashtu të adresojë shumë pika të tjera (p.sh. ndryshimet klimatike dhe varfërinë energjetike) për të angazhuar dhe bindur audiencën të ndryshme.



© Hyperion Energy Community



# SOLAR NË KUTË

SHQIPËRI | RURAL | RAJONALE



Komuniteti i Kutës është përfshirë në mënyrë aktive në betejën e suksesshme kundër projektit të hidrocentralit të Poçemit në Vjosë, për shkak të vendndodhjes së fshatit, i cili do të ndikohej rëndë nga shkëputja e furnizimit me ujë. Por, së bashku me EcoAlbania, banorët kanë provuar se sigurimi i energjisë në mënyrë të qëndrueshme pa hidrocentralin, është lehtësisht e arritshme. Kuta si fshati i parë diellor i vendit, është bërë një projekt i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri.

## Themelimi (viti)

2020.

## Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme



Instalimi i një sistemi panelesh fotovoltaike në çati, në: Shkollën "Ismail Shehaj", Qendrën Kulturorë, Zyrat e Njësisë Administrative, Qendrën Shëndetësore, Rezervuarin e ujit në majë të kodrës dhe stacionin e pompimit, Zëvendësimi i dritave të ndricimit të rrugës dhe ndërimi i llambave.

## Motivimi kryesor (për themelimin)

Le ta ndihmojmë KUTËN të bëhet me energji diellore. Nuk na duhen digat, na ndihmoni të shpëtojmë Vjosën.

Rr. Sali Butka, Objekti TBM construction 2016, shpk, Ap. 24, kati 4, Tiranë, Shqipëri

contact@ecoalbania.org

+355 44 31 7720

[www.ecoalbania.org](http://www.ecoalbania.org)

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Koordinatorja e projektit është grua.

## Aktorët kryesorë dhe palët e përfshira të interesit (përfshirë partneritetet kryesore)

Bashkia e Mallakastrës

Komuniteti Kutë

Kryetari i fshatit

Stafi i shkollës

Anëtarët e këshillit të fshatit

Anëtar vëzhgues i OSHC-së

Njësia Administrative Kutë

Operatori i Sistemit të

Shpërndarjes – OSHEE

## Aktivitetet

Solar në Kutë angazhohet në:

- Krijimin e modelit dhe praktikës së parë të 'komuniteteve energjetike, ose kooperativave energjetike' në Shqipëri.
- Rritjen e ndërgjegjësimit për zgjidhjet e energjisë së rinovueshme të komunitetit rural.
- Nxitjen për projekte të mëtejshme të energjisë diellore dhe të qëndrueshme.
- Mbështetjen e fushatës "Të shpëtojmë Zembrën Blu të Evropës" për betejën kundër ndërtimit të digës së hidrocentralit në Poçem.



# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Si e keni financuar projektin tuaj?

Projekti u financua me mbështetjen financiare të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, Patagonia dhe donacionet (nëpërmjet crowdfunding) nga qytetarët dhe u zbatua nga EcoAlbania, RiverWatch, Euronatur.



© Solar in Küte


## Si e organizuat aksionin tuaj të crowdfunding?

Gjatë vitit 2020, organizatat mjedisore të angazhuara në mbrojtjen e lumit Vjosa nisën fushatën "Solar në Kutë" me qëllim mbledhjen e fondeve për zbatimin e projektit i cili ndihmoi komunitetin e fshatit Kutë, si një nga komunitetet më të prekura nga hidrocentrali i Poçemit. Pas një fushate të suksesshme u bë i mundur sigurimi i fondeve për zbatimin e fazës së parë të projektit Solar në Kutë. Një synim më ambicioz është shndërrimi i të gjithë fshatit Kutë në një fshat me energji diellore, që e prodhon vetë energjinë e nevojshme përmes instalimit të paneleve në çatitë e shtëpive të tyre.

## Cilën platformë keni përdorur? Përse?

Ne kemi përdorur platformën [GoFundMe](#), e cila u autorizua nga Patagonia dhe Euronatur.

“Së bashku me EcoAlbania, banorët kanë provuar se sigurimi i energjisë në mënyrë të qëndrueshme pa hidrocentralin, është lehtësisht e arritshme. Kuta si fshati i parë diellor i vendit, është bërë një projekt i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri.”





Božidarevićeva 13, 4.floor,  
10000 Zagreb, Croatia

contact@zez.coop  
+385 1 2095 552

[www.zez.coop](http://www.zez.coop)

# ZEZ (GREEN ENERGY COOPERATIVE)

KROACI | URBANE | KOMBËTARE



## PYETJE & PËRGJIGJE

### Si e keni financuar projektin tuaj?

Ne financohemi kryesisht nga projektet e BE-së, të ndjekura nga shkrimi i punimeve kërkimore për kompani të ndryshme, duke bashkëpunuar me instaluesit dhe projektuesit e projekteve, duke punuar në mënyrë aktive me qytete, duke edukuar mbi energjinë diellore dhe duke organizuar seminarë mbi temën.

### Cilën platformë keni përdorur? Përse?

Crowdfunding është organizuar përmes Indiegogo dhe ZEZinvest.

### Si e organizuat aksionin tuaj të crowdfunding?

Po, ne kemi mbështetur fushata të ndryshme crowdfunding:

- Shkollën e pavarur të energjisë Kaštel Lukšić (crowdfunding bazuar në donacione).
- Investimi në dy termocentrale diellore në qytetin e Križevci-t (crowdfunding i bazuar në shpërblim).
- Solarna Pecka (crowdfunding i bazuar në donacione).





## VETËFINANCIMI DHE HUATË BANKARE

Përveç vetëfinancimit, disa komunitete energjetike zgjedhin edhe huatë bankare. Huatë bankare, ose financimi i borxhit, është një burim financimi që kërkon kolateral dhe pagesa interesi. Fatkeqësisht, bankat tradicionale prirën të mos financojnë projekte energjetike të qytetarëve, pasi i shohin ato si më të

komplikuara dhe më të vogla. Bankat tradicionale gjithashtu mund të kërkojnë kujdes të mëtejshëm ndaj drejtuesve të projektit, për të verifikuar kolateralin dhe aftësinë për të udhëhequr projektin, gjë që mund të shtojë kosto shtesë të konsiderueshme nga 20 deri në 30.000 euro.

### CILAT JANË KARAKTERISTIKAT E NJË HUAJE TRADICIONALE BANKARE?

- Shuma e rëndësishme: > 500 mijë euro / 1 milion euro.
- Normat e interesit: në varësi të "kostos së tregut të parasë" - mjaft e ulët në Evropë për momentin - për shembull midis 4 dhe 5% për një periudhë prej 10/15 vjetësh.
- Mund të kërkohej kujdesi i duhur i mëtejshëm.

Megjithatë, duhet theksuar se kreditë ndryshojnë nga banka në bankë dhe vlerësohen gjithmonë rast pas rasti.

### Mjete specifike të nevojshme për të organizuar një kredi bankare tradicionale/ Çfarë ju nevojitet për të krijuar një kredi bankare tradicionale?

Për të pasur akses në një kredi bankare tradicionale, është e nevojshme të jeni të paktën në fazën e ndërtimit të një projekti dhe të kërkonit një shumë prej të paktën 500.000 euro / 1 milion euro. Në përgjithësi, pronarët e projekteve gjithashtu duhet të sjellin të paktën 20% të vetëfinancimit për 80% të kredisë dhe të paguajnë për një proces të kujdesit të duhur që kontrollon realizueshmërinë teknike dhe ekonomike të projektit si dhe garancitë. Është gjithashtu e nevojshme që kooperativa të sjellë disa lloje të ndryshme garancish:

- Garancitë e ndërtesës (ose të qirasë hipotekore afatgjatë, nëse ndërtesën e keni me qira),
- Garancia e mjeteve të prodhimit,
- Ndonjëherë një llogari bankare me 6 muaj rimbursime të kredisë, e bllokuar.

### Çfarë lloj kthimi?

Kthimi zakonisht paguhet si interes në kuotën e aksionit në fund të vitit financiar, në varësi të asaj se sa mirë është tregtuar aktivi dhe pasi anëtarët kanë votuar për mënyrën e shpërndarjes së fitimeve në Asamblenë e Përgjithshme. Zotëruesve të obligacioneve u paguhet interesi në bazë të vlerës së obligacioneve të tyre. Me fjalë të tjera, obligacionet funksionojnë si kredi të dhëna nga qytetarët.

Banka Etike, misioni i së cilës nuk është të maksimizojë fitimin, por promovimi i projekteve kulturore, sociale dhe ekologjike: nuk investon në tregjet financiare dhe jep kredi ekskluzivisht për projekte ekonomikisht të qëndrueshme të ekonomisë sociale: bujqësi organike, projekte sociale ose kulturore, kursim energjie, prodhim të energjisë së rinovueshme etj.

Organizon gjithashtu një qarkullim transparent të parave; lista e projekteve të financuara publikohet çdo vit. Në shumicën e rasteve ato janë banka kooperative: kursimtarët dhe huamarrësit janë gjithashtu anëtarë të kooperativës dhe kanë të drejtë vote çdo vit gjatë asamblesë së përgjithshme. Përveç të drejtës së votës, bankat etike u ofrojnë kursimtarëve dhe huamarrësve mundësinë për të krijuar lidhje mes tyre, gjë që përfaqëson një vlerë të shtuar të fortë për menaxherët e projekteve bashkëpunuese.

**Zbuloni më shumë në:** <https://www.compile-project.eu/products/coolkit/financing/>



54626 Thessaloníki, Greece

contact: Alice Corovessi

info@wencoop.gr

+302310 224440

[www.wencoop.gr](http://www.wencoop.gr)

## WENCOOP

GREQI | RURAL | KOMBËTARE



# PYETJE & PËRGJIGJE

### Si e financuat projektin tuaj?

Crowdfunding midis anëtarëve  
[një pjesë e madhe e kësaj do të synohet të riinvestohet në projektet e ardhshme, p.sh. sigurimi i tokës, lejet, pagesa e tarifave të lidhjes me rrjetin] - shumica dërrmuese për projektin e parë do të vijë nga një kredi bankare.

### Ndonjë këshillë?

Kërkoni me shumë kujdes në banka të ndryshme dhe ofertat e ndryshme që secila propozon. Do të ketë refuzime, por përfundimisht do të gjendet një zgjidhje.

### Si keni arritur të merrni kredinë bankare?

Nuk ishte një proces i lehtë: kishim vendosur kushtet e lidhjes së rrjetit, një sasi të konsiderueshme kapitali në bankën e komunitetit energjetik nga anëtarët dhe në fund u kërkuan formularët e taksave të anëtarëve të Bordit. Prandaj, për të siguruar një kredi bankare është e nevojshme të demonstrohet se komuniteti energjetik ka vullnetin dhe kapacitetin aktual për të realizuar projektin.



# 7

## VEPRIMTARITË

Komunitetet e energjisë mund të fokusohen në një larmi të madhe aktiviteteesh. Në funksionimin e tyre, ato mund të përdorin shumë lloje të ndryshme teknologjish për të arritur qëllimet e tyre. Ajo që është thelbësore, është të gjeni aktivitetin që i përshtatet më mirë nevojave dhe mundësive të komunitetit tuaj.

### PRODHIMI: ENERGJIA DIELLORE

Shumica e projekteve energjetike të komunitetit në Evropë janë diellore. Në fakt, energjia diellore është teknologjia e përsosur për projektet e komunitetit. Mund të prodhojë më pak se energjia e erës, megjithatë, është një fillim i mirë falë çmimit më të lirë dhe proceseve më të thjeshta të planifikimit.





contact: Vasilis Roussakis,  
Vice Mayor of Chalki  
vasillys@hotmail.com  
+306944995011

[www.chalkion.gr](http://www.chalkion.gr)

# CHALKI ENERGY COMMUNITY

GREQI | RURAL (ISHULL) | RAJON (ISHULL)



## PYETJE & PËRGGJIGJE



### **Pse keni zgjedhur të përqendroheni te energjia diellore?**

Energjia diellore ishte modeli më i realizueshëm për rajonin e zgjedhur (Halkidiki) për shkak të faktorëve të ndryshëm: disponueshmëria e parcelave të tokës, teknologjia më e thjeshtë dhe më e lehtë me procese jo të gjata autorizimi dhe potenciali i mirë i gjenerimit diellor.

### **Ndonjë këshillë?**

Lloji i energjisë duhet të zgjidhet bazuar në nevojat, disponueshmërinë, kontekstin dhe profilin e anëtarëve. Gjatë fazave të planifikimit duhet të kryhet një analizë e plotë SWOT për të krahasuar teknologji të ndryshme.

### **A mund të thoni disa fjalë mbi projektin tuaj?**

Është një park diellor 1 MW, i cili është në pronësi të përbashkët të 60+ anëtarëve të komunitetit. Energjia elektrike e prodhuar do t'i shitet rrjetit, duke gjeneruar të ardhura për anëtarët.

# SOLAR NË KUTË

SHQIPËRI | RURAL | RAJONALE



## PYETJE & PËRGJIGJE



### Përse keni zgjedhur të përqendroheni te energjia diellore?

Ne synojmë të vërtetojmë se nuk ka nevojë për hidrocentrale nëse potenciali i madh i energjisë diellore në Shqipëri mund të shfrytëzohet për të prodhuar energji dhe për të krijuar të ardhura për çdo komunitet. Me sigurimin e mëtejshëm të energjisë diellore të pastër, të besueshme dhe të përbalueshme, ne mund ta drejtojmë të ardhmen ekonomike të Shqipërisë drejt qëndrueshmërisë.

### A mund të thoni disa fjalë mbi projektin tuaj?

Fushata 'Solar in Kutë', një nismë e organizatave partnere EcoAlbania, EuroNatur dhe Riverwatch, u lançua zyrtarisht në datën 26 maj dhe solli në vëmendje të publikut historinë e komunitetit Kutë në mbrojtjen e lumit Vjosa dhe kapacitetin për prodhimin e energjisë diellore në çatitë e ndërtesave pa qenë nevoja për të shkatërruar lumin Vjosa. Objektivi kryesor i projektit pilot është të sjellë një burim të pastër dhe të qëndrueshëm energjie (diellore) në fshatin Kutë dhe të përmirësojë aksesin në energjinë e rinovueshme, duke krijuar fshatin e parë diellor në Shqipëri.

Rr. Sali Butka, Objekti TBM construction 2016, shpk, Ap. 24, kati 4, Tirana, Albania

contact@ecoalbania.org

+355 44 31 7720

[www.ecoalbania.org](http://www.ecoalbania.org)



Banorët e fshatit Kutë. Zëvendës Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, nën kryetari i Mallakastrës, përfaqësues të EcoAlbania dhe pjesëmarrës të tjerë përpara Qendrës Shëndetësore të fshatit gjatë inaugurimit të fshatës Solar në Kutë. © Christiane Schmidt



**Zelena  
Energetska  
Zadruga**

Božidarevićeva 13, 4.floor,  
10000 Zagreb, Croatia

contact@zez.coop  
+385 1 2095 552

**[www.zez.coop](http://www.zez.coop)**

# ZEZ (GREEN ENERGY COOPERATIVE)

KROACI | URBANE | KOMBËTARE



## PYETJE & PËRGJIGJE



### **Pse keni zgjedhur të përqendrohni te energjia diellore?**

Ekzistonte nevoja për këshilla profesionale në lidhje me energjinë diellore dhe edukimin me një treg të pashfrytëzuar diellor që ende nuk ka lulëzuar.

### **A mund të thoni disa fjalë mbi projektin tuaj?**

Ne kemi zhvilluar një platformë "Në anën e diellit" për të lidhur njerëzit pa energji diellore me projektues dhe instalues diellor që ofrojnë këshilla dhe edukim të cilësisë së lartë.

## PRODHIMI: BIOMASA

Kur vjen nga mbetjet e pyjeve, mbetjet bujqësore, mbetjet ushqimore, pyjet apo mbetjet e tjera të drurit, biomasa mund të konsiderohet si lëndë djegëse e rinovueshme. Ju mund të emetoni CO<sub>2</sub> nga djegia e druve, por ky karbon përfundimisht do të absorbohet nga rritja e re që zëvendëson atë që digjet. Megjithatë, ajo që është thelbësore, është se nuk merret gjithmonë si e mirëqenë që kjo rritje e re do të ndodhë. Kjo është arsyeja pse biomasa nuk është e përshtatshme për vendosje në shkallë të gjerë, por për disa komunitete, ajo mund të jetë pjesë e zgjidhjes, veçanërisht kur burimet lokale menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme.



© ESEK



© ESEK



Agiophgh, 43100, Greece,  
Thessaly, Karditsa,

info@esek.gr,  
+30 6945179170

[www.esek.gr](http://www.esek.gr)

## PYETJE & PËRGJIGJE

### Përse keni zgjedhur të përqendroheni te biomasa?

Bioenergjinë është teknologjia udhëheqëse në sektorin e ngrohjes me energji të rinovueshme të BE-së dhe ka potencialin më të lartë për zëvendësimin e ngrohjes me lëndë djegëse fosile. Kështu, ekspertët sugjerojnë se bioenergjinë mund të jetë përgjegjëse për një sasi të konsiderueshme të këtij potenciali të ngritjes së tregut dhe zgjerimi i saj është vendimtar për përmbushjen e objektivave të mësipërm. Shoqata Ndërkombëtare e Energjisë e sheh bioenergjinë si burimin kryesor për një sektor ngrohjeje me më pak lëndë djegëse fosile deri në vitin 2030, ndërsa Shoqata Botërore e Bioenergjisë

# KOMUNITETI ENERGJETIK I KARDITËS (ESEK)

GREQI | RURAL | RAJONALE

e konsideron sektorin e ngrohjes si "sektorin e vetëm më të rëndësishëm të zhvillimit në të ardhmen e biomasës". Biomasa është forma e parë e energjisë së rinovueshme që komuniteti kishte zgjedhur për të krijuar një zinxhir vlerash. Për të prodhuar energji nga biomasa është e nevojshme të përfshihen shumë palë të interesit, si transportuesit e biomasës, furnizuesit e biomasës (kantieret e sharrave, kooperativat pyjore, fermerët, bashkitë), furnizuesit e materialeve konsumuese, teknikët (hidraulikët, elektrikistët, inxhinierët) etj. Në këtë mënyrë komunitetet mund të krijojnë një zinxhir vlerash dhe të sigurojnë të ardhura për komunitetin. Rajoni ka potencial të madh në zinxhirin e furnizimit me biomasë përmes industrive bujqësore, pyjore dhe të përpunimit të drurit, të cilat mund të mbështesin lehtësisht përvetësimin e teknologjive të bioenergjisë.

ESEK aktualisht po përballet me dy sfida kryesore:

- Zhvillimi dhe zgjerimi i rasteve të biznesit për kalidaja me biomasë në ndërtesat komunale: Aktualisht ka angazhim nga komunat pjesëmarrëse në ESEK për të kontribuar në zhvillimin e biomasës komunitare, megjithatë ka ende punë planifikuese që nevojitet të bëhet, në mënyrë që të qartësohet vlera e biznesit për përdoruesit përfundimtarë dhe komunat.

- Zhvillimi i energjisë diellore në komunitet: aktualisht ka interes nga anëtarët e komunitetit për bashkëfinancimin dhe zhvillimin e një projekti të komunitetit të energjisë diellore, por duhet të kryhet puna e planifikimit për të zhvilluar modelin e biznesit dhe rastin e biznesit për një fermë me energji diellore.

### A mund të thoni disa fjalë mbi projektin tuaj?

Që nga nëntori i vitit 2020, Komuniteti i Energjisë i Karditsa-s merr pjesë si pilot në projektin evropian Horizon 2020, BEcoop. Projekti synon t'i bëjë projektet e komunitetit të bioenergjisë më tërheqëse për aktorët e mundshëm të interesit dhe të nxisë lidhje dhe partneritete të reja midis komunitetit ndërkombëtar të bioenergjisë. Projekti heton dhe specifikon lehtësuesit dhe pengesat për pranimin e tregut të bioenergjisë nga komuniteti dhe, duke u mbështetur mbi këtë informacion, fuqizon më tej politikëbërësit të prezantojnë korniza mundësuese për bioenergjinë e komunitetit.





## EFIKASITETI I ENERGJISË

Efikasiteti i energjisë është një fushë e aktivitetit për shumë komunitete energjetike. Objektivi që qëndron pas këtyre nismave është shpesh arritja e një ekuilibri midis konsumit dhe prodhimit të BRE. Kjo bëhet duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke inkurajuar investimet nga anëtarët në mënyrë që ata të kursejnë para në faturat e tyre të energjisë. Kjo është një mënyrë e shkëlqyer për të filluar aktivitetet

dhe për të fituar përvojë dhe besim në komunitet, veçanërisht në fillim. Ndërsa shumë iniciativa për efikasitetin e energjisë të kryera nga komunitetet energjetike janë aktivitete të pavarura, shumë janë gjithashtu të lidhura me projektet e komunitetit të energjisë së rinovueshme, të cilat ofrojnë një burim të ardhurash për investime në rinovime dhe teknologji të kursimit të energjisë.



© Shutterstock



# BASHKIA HAS DHE KOMUNA KLINË (NDRIÇIMI LED)

SHQIPËRI DHE KOSOVË | URBANE | NDËRKOMBËTARE

"GREEN CROSS – Drejt Ekonomive Lokale të Gjelbërta me Investime të Mençura), është një projekt ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

## Shtirja gjeografike (rajonale/kombëtare)

Bashkia Has, Shqipëri dhe Komuna Klinë, Kosovë.

## Themelimi (viti)

2020.

## Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

Llamba LED me sistem errësues (në ambiente të jashtme), llamba LED në ambiente të brendshme dhe panele diellore në ndërtesat publike.

## Motivimi kryesor (për themelimin)

Projekti është i fokusuar të orientojë komunitat drejt zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë së gjelbër përmes investimeve, aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve; dhe aktivitete ndërgjegjësuese.

EDEN center  
eden@eden-al.org

[www.eden-al.org](http://www.eden-al.org)

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Rolet vendimmarrëse:  
Menaxherët e projektit.

Gjinia e ekipit kryesor:  
50% Femra, 50% Meshkuj.

## Aktorët kryesorë dhe palët e përfshira të interesit (përfshirë partneritetet kryesore)

Stafi i Hasit dhe Komunës Klinë:  
zyrat rregullatore të energjisë;  
shkolla, kopshte, qendra  
shëndetësore, biznese lokale,  
qytetarë etj.

## Aktivitetet

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

- Ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e gjelbër (trajtime)
- Investime të mençura për llambat LED të jashtme dhe të brendshme dhe panelet diellore.
- Vizita studimore për praktikat më të mira në efikasitetin e energjisë.
- Aksionet e vizibilitetit.

# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Përse keni zgjedhur të fokusoheni në efikasitetin e energjisë?

Efikasiteti i energjisë është zgjidhja optimale për të ulur kostot e energjisë, për të ofruar të njëjtat shërbime edhe më mirë, dhe për të reduktuar emetimet e gazrave serrë në atmosferë.

## A mund të thoni disa fjalë mbi aksionin tuaj LED?


Aksioni LED, me llambat e jashtme (llambat 220 HPS, u zëvendësuan me llamba më efikase te tipit LED) ka rezultuar në kursim të energjisë, ka reduktuar faturën e komunës për shpenzimet e ndriçimit të jashtëm, duke bërë në këtë mënyrë kursime në buxhetin e bashkisë.

## Ndonjë këshillë?

Komunikimi me qytetarët dhe vetë bashkinë për përfitimet e investimeve të LED, është thelbësor për t'i mirëpritur këto investime që sjellin risi. Është e rëndësishme të kuptohet se kostoja përfundimtare mund të jetë e lartë, por priten përfitime afatgjata.



© Eden Centre





# VLORA (AKSION PËR VARFËRINË ENERGIJETIKE)

SHQIPËRI | ZONË GJYSMËRURALE | QASJE RAJONALE

EmpowerMed synon të trajtojë varfërinë energjetike dhe të ndihmojë në përmirësimin e shëndetit të njerëzve në zonat bregdetare të vendeve të Mesdheut, me një fokus të veçantë tek gratë. Në vendet e Mesdheut, zonat bregdetare përballen me disa sfida specifike të varfërisë energjetike, veçanërisht lidhur me komoditetin termik të banesave. Ndërtesat janë të pothuajse të paizoluara, shpesh pa asnjë sistem ngrohjeje, ose tepër joefikase. Një element i rëndësishëm i varfërisë energjetike në këto zona është edhe komponenti ftohës. Varfëria energjetike prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe familjet e udhëhequra nga gratë. Në të njëjtën kohë, gratë janë një aktor i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë energjetike.

## Themelimi (viti)

2019.

## Teknologjitë e Energjisë së Rinovueshme

Instalimi i paneleve diellore në çatinë e Shkollës Publike Profesionale Vlorë. Pajisje të vogla me efikasitet energjetik për të mbështetur familjet në kushte të varfërisë energjetike.

Milieukontakt Albania  
office@milieukontakt.org

+355 42 256 528  
+355 688048363

[www.milieukontakt.org](http://www.milieukontakt.org)

## Motivimi kryesor (për themelimin)

Motivimi kryesor ishte promovimi i BRE-ve, në veçanti i energjisë diellore për të trajtuar varfërinë energjetike dhe për të ndihmuar në përmirësimin e shëndetit të njerëzve në zonën bregdetare, me vëmendje të veçantë tek gratë.

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Drejtuësja e organizatës është grua, dhe një nga 2 koordinatorët lokalë është grua.

## Aktorët kryesorë dhe palët e përfshira të interesit (përfshirë partneritetet kryesore)

Milieukontakt Albania dhe partnerët e EmpowerMed.

NJQV, OSHC lokale, qendra e shëndetit publik dhe shoqëria e shërbimeve.

Projekti synonte grupet e mëposhtme të marginalizuara: të moshuarit, kryesisht gra; familjet me një prind, kryesisht nëna beqare, komunitetet etnike (rom, egjiptian); të papunë dhe të punësuar por në rrezik të varfërisë, kryesisht gra.

## Aktivitetet

Aksioni për varfërinë energjetike i Vlorës dëshiron të:

- Mobilizojë dhe përfshijë aktorët kryesorë lokalë.
- Zhvillojë partneritete të mëdha (plani i veprimit territorial) për të arritur grupet më vulnerabël.
- Organizojë ngritjen e kapaciteteve të aktorëve dhe familjeve. Të përdorë qasjen e nismave të komuniteteve të reja.
- Mbështesë fuqizimin e familjeve nëpërmjet seminareve "Bëje vetë".
- Gjejë zgjidhjet më të mira të përshtatura për nevojat reale (sociale, ekonomike, mjedisore).
- Dëgjojë, kuptojë dhe qëndrojnë në aspiratat e familjeve.
- Përdorë një komunikim praktik dhe të përshtatur.
- Veprojnë në nivel politik.

# PYETJE & PËRGGJIGJE

## **Përse keni zgjedhur të fokusoheni në efikasitetin e energjisë?**

Efikasiteti i energjisë kursen para. Redukton faturat mujore të energjisë dhe e bën energjinë më të përballueshme për familjet. Disa produkte me efikasitet energjetik kushtojnë më shumë për t'u blerë se opsionet e tjera, por ato zakonisht ju kursajnë para në planin afatgjatë. Familjet që përfuturojnë pasiguri energjetike mund të përballen me zgjedhjen e vështirë midis pagesës së faturave mujore të energjisë ose vendosjes së ushqimit në tryezë. Efikasiteti i energjisë mund t'i ndihmojë familjet financiarisht dhe të përmirësojë shëndetin, komoditetin dhe sigurinë e familjeve në shtëpitë e tyre.

Milieukontakt Albania është partneri i aktiviteteve të zbatimit të projektit në bashkinë e Vlorës. Hapi i parë i projektit ishte ndërtimi i rrjeteve të aktorëve lokalë në 6 zona pilot (Vlorë – Shqipëri, Barcelonë – Spanjë, Marsejë – Francë, Padova – Itali, Primorska – Slloveni dhe Zadar – Kroaci) dhe transferimi i njohurive dhe përvojës thelbësore për ngritjen e kapaciteteve të të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e masave praktike.

Thelbi i projektit është zbatimi i masave praktike për të trajtuar varfërinë energjetike, të tilla si qasje të bazuara në komunitet, vizita në familje, qasje të pavarura, mbështetje për investime të vogla dhe seminare shëndetësore. Efektiviteti dhe ndikimet e veprimeve të zbatuara do të vlerësohen dhe analizohen, dhe rezultatet do të ndihmojnë në formulimin e rekomandimeve të politikave. Këta aktorë kryesorë do të mbështesin promovimin e politikave kundër varfërisë energjetike.

## **A mund të thoni disa fjalë mbi aksionin tuaj mbi varfërinë energjetike?**

Projekti u dhuroi familjeve disa pajisje që shërbejnë për të kursyer energjinë elektrike, si izolim për dyer dhe dritare, llamba LED, zgjatues rryme, koka dushi etj. Instalimi u ndoq me këshilla nga auditorët për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike, këshilla për kursimin e energjisë dhe ujit. Duke kontrolluar konsumin e tyre, ata do të mund të kontrollojnë faturat e energjisë elektrike dhe ujit.

Ne kemi organizuar takime të ndryshme sensibilizuese në bashkinë e Vlorës dhe jemi në bashkëpunim me shkollën profesionale të qytetit. Plani ynë

është që të investojmë në panele diellore në çatinë e objektit të shkollës me qëllim reduktimin e kostos së faturave të energjisë.

Modeli dhe mjetet që janë krijuar në EmpowerMed mund të përsëriten në rajone të tjera të Shqipërisë dhe më gjerë, duke kontribuar në rritjen e aksesit të sigurt në energji për të gjithë, por edhe në kursimin e energjisë dhe konsumin adekuat të përshtatur me kushtet klimatike dhe sociale ku po jetojmë.

## **Ndonjë këshillë?**

Një tranzicion i drejtë energjetik është një shtyllë kyçe e Axhendës së Gjellbër të BE-së për Ballkanin. Të dhënat për varfërinë energjetike kryesisht nuk janë të ndara sipas gjinisë dhe është roli ynë t'i ndryshojmë ato duke përfshirë një lente gjinore.



© Projekti EmpowerMed



7, Olympionikon Street  
PC 16342, Athens, Greece

contact: Chris Vrettos  
chris@electraenergy.coop  
+306948387911

[www.electraenergy.coop/here-comes-the-sun-first-community-solar-farm-in-greece/](http://www.electraenergy.coop/here-comes-the-sun-first-community-solar-farm-in-greece/)

[www.hyperioncommunity.com](http://www.hyperioncommunity.com)

## HYPERION

GREQI | URBANE | RAJONALE / KOMBËTARE



## PYETJE & PËRGGJIGJE

### **Përse keni zgjedhur të fokusoheni në efikasitetin e energjisë?**

Efikasiteti i energjisë, para së gjithash është një parim që bashkon shumicën e ambientalistëve. Kursimi i energjisë mund të kontribuojë në: 1) uljen e varfërisë energjetike, 2) rritjen e integritit relativ të energjisë së rinovueshme në rrjet, 3) gjenerimin e të ardhurave për qytetarët.

### **Ndonjë këshillë?**

Partneritete, p.sh. me organizata, ekspertiza e të cilave është efikasiteti i energjisë, janë kyçe.

### **A mund të thoni disa fjalë mbi projektin tuaj?**

Hyperion po fillon një partneritet me Institutin Grek Passive House për t'u ofruar anëtarëve të tij (si dhe anëtarëve të komuniteteve të tjera të energjisë) shërbime të tilla si: 1) vizita brenda shtëpisë, këshillim dhe konsultime se si të reduktojnë konsumin e tyre të energjisë, 2) sasi të mëdha -blerja e pajisjeve me efikasitet të lartë energjetik, 3) rinovimi i banesave. Në këtë mënyrë, varfëria energjetike trajtohet në rrënjë.

## KONSULENCA DHE SHËRBIMET KËSHILLIMORE PËR NISMAT E KOMUNITETEVE TË REJA

Ekzistojnë shumë komunitete energjetike që ofrojnë një sërë shërbimesh për të mbështetur të ngjashmit e tyre, qytetarët dhe organizatat qytetare të interesuara për të krijuar një komunitet energjetik dhe për të filluar një projekt energjetik në komunitet, por edhe organizata të tjera, si autoritetet lokale dhe/ose politikëbërësit kombëtarë, që duan të punojnë në energjinë e komunitetit.



© REScoop.eu



7, Olympionikon Street  
PC 16342, Athens, Greece

contact: Chris Vrettos  
chris@electraenergy.coop  
+306948387911

[www.electraenergy.coop/here-comes-the-sun-first-community-solar-farm-in-greece/](http://www.electraenergy.coop/here-comes-the-sun-first-community-solar-farm-in-greece/)

[www.hyperioncommunity.com](http://www.hyperioncommunity.com)

## HYPERION

GREQI | URBANE | RAJONALE / KOMBËTARE



### PYETJE & PËRGGJIGJE

#### Përse keni zgjedhur të përqendroheni në këshillimin dhe konsultimin P2P?

Solidariteti dhe ndihma ndër-bashkëpunuese është sanksionuar në 7 parimet e bashkëpunimit. Rrjetëzimi, informacioni dhe shkëmbimi i kapaciteteve mund të nxisin rritjen e komuniteteve të reja të energjisë dhe të ndihmojnë në stabilizimin e operacioneve të atyre ekzistuese.

#### A mund të thoni disa fjalë mbi nismën tuaj?

Hyperion ka qenë aktivisht i përfshirë në krijimin e grupit të parë kombëtar grek të komuniteteve të energjisë. Anëtarët e Hyperion, shumica e të cilëve vijnë me baza nga sektorët e mjedisit dhe energjisë, gjithashtu ofrojnë rregullisht këshilla dhe udhëzime pro bono për komunitetet e tjera të energjisë, si dhe për publikun e gjerë.



Zelena  
Energetska  
Zadruga

Božidarevićeva 13, 4.floor,  
10000 Zagreb, Croatia

contact@zez.coop  
+385 1 2095 552

[www.zez.coop](http://www.zez.coop)

## ZEZ (GREEN ENERGY COOPERATIVE)

KROACI | URBANE | KOMBËTARE



### PYETJE & PËRGGJIGJE

#### Përse keni zgjedhur të përqendroheni në këshillimin dhe konsultimin P2P?

Ligjet dhe teknologjitë e energjisë së rinovueshme janë ende në zhvillim në Kroaci, kështu që ka një nevojë të madhe për konsulencë dhe këshillim P2P.

#### A mund të thoni disa fjalë mbi nismën tuaj?

Ne ofrojmë këshilla falas dhe lidhim qytetarët me projektues dhe instalues të energjisë diellore.



## FURNIZIMI ME ENERGI

Gjithnjë e më shumë komunitete të energjisë zgjedhën të operonin si furnizues të energjisë. Ka disa mënyra për ta bërë këtë: disa iniciativa prodhojnë energjinë e tyre dhe ua shesin atë klientëve të tyre, ndërsa të tjera blejnë dhe grumbullojnë energji të rinovueshme nga prodhues të tjerë për anëtarët e tyre. Kriza e fundit energjetike ka treguar se është e rëndësishme të zotëroni kapacitetet të mjaftueshëm gjenerues për energjinë

që dëshironi t'u furnizoni anëtarëve dhe/ose klientëve tuaj. Të bëhesh një furnizues kooperativ i energjisë vjen me sfidat e veta, të cilat ndërlidhen, ndër të tjera me rregulloret, ndikimin e aktorëve të vendosur të tregut dhe kufizimet financiare. Mos u dëshpëroni nëse komuniteti juaj has në një pengesë. Kjo është krejtësisht normale dhe me ndihmën e kooperativave të tjera do të gjeni një zgjidhje!



© Shutterstock



# COOPERATIVA DE ENERGIE

RUMANI | URBANE | KOMBËTARE



Anëtarët themelues përbëhen nga një grup sipërmarrësish, specialistësh dhe analistësh, të cilët së bashku kanë krijuar Cooperativa de Energie, furnizuesin dhe prodhuesin e parë të energjisë së gjelbër, duke përdorur kuadrin kooperativë, në Rumani.

## Themelimi (viti)

2019.

## Motivimi kryesor (për themelimin)

Prodhimi dhe furnizimi me energji elektrike të rinovueshme për komunitetin lokal dhe përmirësimi i perspektivës së energjisë së rinovueshme në Rumani dhe Evropën Jug-Lindore.

verde@cooperativadeenergie.ro  
+40740542824

[www.cooperativadeenergie.ro](http://www.cooperativadeenergie.ro)

## Rolet vendimmarrëse dhe përbërja gjinore e ekipit kryesor (përqindja për pozicion)

Bordi aktualisht përbëhet nga 4 anëtarë, të gjithë meshkuj. Vendimet merren në bazë të demokracisë, me votim, si në bordin drejtues, ashtu edhe në mbledhjen e anëtarëve.

## Aktorët kryesorë dhe palët e përfshira të interesit (përfshirë partneritetet kryesore)

REScoop.eu, Som Energia, kooperativa të tjera.

## Aktivitetet

Furnizimi me energji të rinovueshme, edukimi.

# PYETJE & PËRGGJIGJE

## Përse keni zgjedhur të përqendrohni në furnizimin me energji?

Në Rumani qytetarët e zakonshëm nuk kishin se si të përfshiheshin në tregun e energjisë, të mësonin dhe të vepronin.

Kur patëm mundësinë të fokusoheshim në biznesin e furnizimit me energji të rinovueshme, vendosëm se është një mënyrë e shkëlqyer për klientët, që të mësojnë rreth energjisë dhe është gjithashtu e lehtë për t'u shkallëzuar dhe për të pasur një ndikim më të madh. Hapi tjetër është të bëheni prodhues të energjisë së rinovueshme sa më shpejt të jetë e mundur.

## A mund të thoni disa fjalë mbi nismën tuaj?

Cooperativa de Energie është kooperativa e parë energjetike në Rumani dhe qëllimi ynë është të krijojmë një komunitet të qëndrueshëm (si nga pikëpamja mjedisore ashtu edhe nga një këndvështrim sipërmarrës) për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë më shumë rreth energjisë së rinovueshme dhe t'i bëjmë ata aktorë në treg.

## Ndonjë këshillë?

Qëndroni të fortë :D

Këshilla jonë më e mirë është, ta mbani gjithmonë komunikimin tuaj të qartë dhe të singertë me komunitetin tuaj.

ROMANIA



© Cooperativa de Energie

## 8

## ENERGJIA KOMUNITARE PËR... TEJKALIMIN E “BALLKANIZIMIT”

**Kriza e vazhdueshme energjetike ka goditur mjaft rëndë shumicën e vendeve në rajonin e Ballkanit, duke theksuar se modeli aktual i energjisë nuk është i qëndrueshëm teknikisht, ekonomikisht, dhe nuk është mjedisor apo social. Në shumicën e vendeve të rajonit prodhimi i energjisë bazohet në djegjen e lëndëve djegëse fosile, ndërsa përzierja e energjisë së rinovueshme kryesisht (nëse jo ekskluzivisht) përbëhet nga biomasa tradicionale dhe hidrocentrale të mëdha.**

Ndërkohë që sektori termoenergjetik përballet me probleme në funksionimin apo furnizimin e termocentraleve ekzistuese me qymyr apo gaz, qytetarët kanë nisur ta marrin këtë çështje në duart e tyre, duke demonstruar se është e mundur një mënyrë tjetër organizimi i sektorit të energjisë. Ata krijojnë komunitete energjetike dhe zhvillojnë projekte të orientuara nga qytetarët për energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë në lagjet e tyre, duke hapur rrugën për një tranzicion energjetik gjithëpërfshirës dhe të drejtë nga njerëzit për njerëzit.

Siç ilustron në këtë udhëzues, qytetarët në rajonin e Ballkanit kanë filluar të testojnë energjinë e rinovueshme dhe teknologjitë e efikasitetit të energjisë dhe të përshtatin konceptin e energjisë së komunitetit në kontekstin e tyre, duke përmirësuar në këtë mënyrë jetesën dhe mjedisin e tyre lokal.

Në Greqi, kemi filluar të vërejmë shfaqjen dhe rritjen e shumë komuniteteve energjetike pas futjes së një kuadri mundësues për komunitetet energjetike; megjithatë, vumë re gjithashtu se, aktorë të tjerë komercialë përpiqen të rrëmbejnë konceptin. Nismat e zhvilluara nga Greqia kanë nisur të lidhin dhe të ofrojnë mbështetje për nismat e reja energjetike në

Shqipëri, si dhe në Bullgari, Rumani dhe Moldavi, ku ekziston një bashkëpunim i mirë me autoritetet bashkiake vendore. Në mënyrë të ngjashme, në Kroaci, ndërkohë që shfaqen iniciativa të reja në vend, nismat ekzistuese të zhvilluara tashmë, kanë mbështetur iniciativat në rajonin më të gjerë, si në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, ku një komunitet i parë energjetik është gati të nisë projektin e tij të parë të energjisë në komunitet. Në kontekstin e Akademisë Evropiane të Energjisë Qytetare, shumë prej organizatave të ndryshme qytetare dhe OJQ-je të interesuara për energjinë e komunitetit në rajonin e Ballkanit u mblodhën për të shkëmbyer dhe mësuar nga njëra-tjetra.

Duke bashkuar forcat brenda dhe në të gjitha vendet e rajonit, qytetarët mund të ndërtojnë një rrjet energjetik të komunitetit rajonal, duke forcuar rritjen e energjisë së komunitetit evropian dhe duke përmbytur atë që është njohur si termi "ballkanizim".

**Komunitetet e energjisë mund të udhëheqin decentralizimin dhe demokratizimin e sektorit të energjisë, duke përmirësuar në të njëjtën kohë mirëqenien sociale dhe mjedisin.**

Komunitetet e energjise ofrojnë përfitime ekonomike për anëtarët e tyre, duke forcuar gjithashtu ekonominë lokale duke rritur punësimin dhe duke krijuar mundësi shtesë për biznes. Për më tepër, ato mund të forcojnë kohezionin social, duke mbështetur arritjen e qëllimeve të përbashkëta përmes vendimmarrjes demokratike dhe bashkimit të burimeve, dhe duke bërë të arritshme të drejtën për energji të rinovueshme, komunitetet e energjise aktivizojnë qytetarinë energjetike dhe arrijnë demokracinë energjetike.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> <https://www.mdpi.com/2071-1050/10/11/4106>



Për të lulëzuar dhe zhvilluar projekte shtesë, më novatore, si dhe më të mëdha dhe më me ndikim, këto nisma kanë nevojë për mbështetjen e politikëbërësve në të gjithë Ballkanin. Është bërë e qartë se komunitetet lokale që mund të sigurojnë prodhimin e energjisë së rinovueshme janë në gjendje të mbrohen nga ndikimi i çmimeve të larta të energjisë elektrike dhe gazit me shumicë, dhe paqëndrueshmërisë. Pronësia vendore e prodhimit të energjisë së rinovueshme duhet të njihet si një çështje urgjente për sigurimin e furnizimit me energji.

Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet planifikimit urban, territorial dhe energjetik për prodhimin dhe ruajtjen e burimeve të rinovueshme lokale, së

bashku me infrastrukturën e rrjetit, si dhe politikave dhe masave që stimulojnë prodhimin e energjisë për vetëkonsum kolektiv. Për më tepër, rregulla më të qarta dhe ofrimi i mbështetjes për autoritetet vendore janë të nevojshme, në mënyrë që ato të mund të përdorin prokurimin publik për të bashkëpunuar me iniciativat lokale të udhëhequra nga qytetarët.<sup>4</sup>

Mundësimi i shfaqjes dhe rritjes së komuniteteve energjetike të udhëhequra nga qytetarët është thelbësore për të siguruar që, kalimi drejt burimeve të rinovueshme të energjisë, të lehtësojë një të ardhme të qëndrueshme mjedisore dhe shoqërore të drejtë dhe të barabartë.



© REScoop.eu

<sup>4</sup> <https://www.rescoop.eu/news-and-events/news/a-repowereu-for-energy-citizens-manifesto>

## ORGANIZATAT QË QËNDROJNË PAS KËTIJ UDHËZUESI

**REScoop.EU**

**REScoop.eu** është federata evropiane e kooperativave qytetare të energjisë, që përfaqëson mbi 1900 kooperativa dhe 1.25 milionë qytetarët e tyre. Të themeluar në vitin 2013 dhe duke u mbështetur në disa dekada përvojë me komunitetet e energjisë, ne sigurojmë që zërat e qytetarëve të dëgjojnë në nivel të BE-së dhe mbështesim komunitetet energjetike me ekspertizë teknike, ngritje kapacitetesh dhe komunikim.

  
**ELECTRA ENERGY.**

**ELECTRA Energy** është një kooperativë sociale e certifikuar (e regjistruar me L4430/2016). Ajo u themelua në vitin 2016 dhe është e vendosur në Athinë, Greqi. ELECTRA Energy po udhëheq tranzicionin drejt një sistemi energjetik të decentralizuar, efikas dhe të qëndrueshëm me qytetarët dhe komunitetet lokale në qendër. Për këtë arsye ELECTRA Energy po punon shumë ngushtë me qytetarët dhe komunitetet lokale, komunat, institucionet akademike dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare.

  
**MILIEUKONTAKT**  
SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY

**Milieukontakt Shqipëri** ka një eksperiencë të gjere me organizatat e shoqërisë civile në fushën e mjedisit, natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe me autoritetet vendore që mbulojnë këto çështje në Shqipëri.

Milieukontakt Shqipëri është aktive në çështjet e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të rinovueshme të energjisë që nga viti 2010 me aktivitete mjedisore në nivel shkollash, kryerjen e raporteve të auditimit të energjisë në shkolla, zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë; analizimin e perceptimit dhe njohurive të komunitetit për efikasitetin e energjisë; përgatitjen e broshurave të thjeshta për masat që duhen marrë në shtëpi; përgatitja e studimit mbi ndikimin mjedisor të hidrocentraleve dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mbështet ndryshimet në ligjin për efikasitetin e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë.

**Mirënjohje:** Të trija organizatat dëshirojnë të falenderojnë çdo iniciativë energjetike të drejtuar nga qytetarët e paraqitur në këtë udhëzues për kontributin dhe njohuritë e tyre të vlefshme!

## ËNDËRRONI SHUMË DHE ORGANIZOHUNI PËR TË LEJUAR QË PROJEKTI JUAJ TË RITET!

Të gjitha projektet energjetike të komunitetit janë një udhëtim me shumë kthesa. Qëndroni të përkushtuar dhe dëgjoni njëri-tjetrin. Me ndihmën e ndërsjellë mund të kapërceni çdo pengese!

**Nuk kemi  
kohë për të  
humbur.**

**Momenti për të luftuar  
ndryshimet klimatike dhe  
për të përshpejtuar  
tranzicionin e energjisë  
është TANI.**

**Organizohuni dhe  
bashkohuni me  
revolucionin  
energjetik!**



© REScoop.eu

# AKADEMIA EVROPIANE PËR ENERGJINË E QYTETARËVE

UDHËZUES PËR PRAKTIKAT MË TË  
MIRA NË EVROPËN JUGLINDORE

Nisma frymëzuese mbi komunitetet e energjisë

## ËNDËRRONI SHUMË DHE ORGANIZOHUNI PËR TË LEJUAR QË PROJEKTI JUAJ TË RRITET!

Të gjitha projektet energjetike të komunitetit janë një udhëtim me shumë kthesa. Qëndroni të përkushtuar dhe dëgjoni njëri-tjetrin. Me ndihmën e ndërsjellë mund të kapërceni çdo pengesë!

**Nuk kemi  
kohë për të  
humbur.**

**Momenti për të luftuar  
ndryshimet klimatike dhe  
për të përshpejtuar  
tranzicionin e energjisë  
është TANI.**

**Organizohuni dhe  
bashkohuni me  
revolucionin  
energjetik!**

